



Gjolla për ATSH-në:
Naftë pa taksa për fermerët, mbi 19 000 aplikime në qarkun e Korçës

Faqe 6

Blegtoria, interes i lartë për subvencionet,
mbi 3200 fermerë kanë aplikuar në skemat mbështetëse

Faqe 5

Shqipëri-BE, mbahet në Bruksel Konferenca V Ndërqeveritare - Hapet grupkapitulli i 'Konkurrueshmërisë'

Faqe 2



AGROBIZNESI

FED invest

Rr. "Qemal Stafa", P. 9-katësh,
Nr. 70, Kati 2, Pazari i ri, Tiranë.
Tel: +355 4 2 251 910 /911
Email: info@fedinvest.al
kontakt@fedinvest.al
www.fedinvest.al

BOTIM I KËSHILLIT TË AGROBIZNESIT SHQIPTAR

Adresa: Rruga "Mine Peza", Pallati 87/3, Hyrja 1, Kati i parë, Tel/ Fax: 2229445
E-mail: infokash@yahoo.com www.kash.org.al

15-ditëshi i dytë i muajit maj 2025

Viti i shtatëmbëdhjetë i botimit - Nr. 510
Çmimi 125 lekë

E përdyjavshme e pavarur

SI TË SHMANGNI REFUZIMET NË KUFIRIN E BE-SË SI TË HYNI NË TREGUN E BE-SË ME BIMËT TUAJA: RËNDËSIA E SIGURISË USHQIMORE DHE HIGJENËS PËR EKSPORTUESIT SHQIPTARË TË BAM

Organizata e Kombeve të Bashkuara për Zhvillim Industrial (UNIDO), përmes Programit Global për Cilësi dhe Standarde (GQSP), të mbështetur nga Qeveria Zvicerane përmes Sekretariatit Shtetëror për Çështjet Ekonomike (SECO), po mbështet fermerët dhe ndërmarrjet e vogla e të mesme (NVM) në përmbushjen e standardeve të kërkuara, duke lehtësuar aksesin e tyre në tregjet evropiane dhe ndërkombëtare



Denaj në takimin rajonal të FAO: Modernizim dhe qëndrueshmëri në sektorin agroushqimor

Faqe 2

SUBVENCIONE

Skema kombëtare e mbështetjes në bujqësi, përfundimi i afatit për aplikim në 30 maj

Faqe 12

TEMA TË DITËS

- Kultivimi i grurit, bashkëpunim me QTTB Lushnjë për përzgjedhjen e kultivarëve që japin rendiment Fq.5
- Skema e subvencioneve në bujqësi, në Gjirokastrë aplikime të shumta për naftën Fq.5
- Balla: "Paketa e Maleve", zhvillim agroturizmi në tokat e të parëve Fq.7
- Marrëveshja e pensioneve me Italinë, Manjani: Nuk humbet asnjë ditë pune Fq.7
- Kalendari bujqësor, muaji qershor 2025 - Prof. As. Dr. Eqrem Meçollari Fq.13

SHQIPËRI - IZRAEL

Bashkëpunim me Izraelin për modernizimin e bujqësisë dhe zhvillimin e agrobiznesit



Faqe 5

FINANCIM

Ibrahimaj: Rritja e ekonomisë, historike krijimi i Bankës Kombëtare të Zhvillimit



Faqe 5

TEMA TË DITËS

Eksportet bujqësore shqiptare rritje me gati 4 herë brenda një dekade

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Anila Denaj, deklaroi se eksportet bujqësore shqiptare kanë shënuar një rritje të ndjeshme, duke arritur në 570 milionë euro në vitin 2024, krahasuar me vetëm 150 milionë euro në vitin 2013.

Sipas ministres Denaj, kjo rritje është rezultat i një dekade pune të qëndrueshme, mbështetjes së vazhdueshme për fermerët dhe politikave të orientuara drejt rritjes së prodhimit dhe përmirësimit të standardeve. Ajo theksoi se synimi afatmesëm i qeverisë është arritja e 1 miliardë eurove në eksporte bujqësore deri në vitin 2030.

Përmirësimi i infrastrukturës agrare, nxitja e agroturizmit, skemat e subvencioneve për fermerët, si dhe certifikimi dhe standardizimi i prodhimeve vendase kanë kontribuar në rritjen e konkurrueshmërisë në tregjet ndërkombëtare.

“Transformimi i sektorit sot është një realitet,” u shpreh Denaj, duke theksuar vendosmërinë për të vijuar me politika mbështetëse për të gjithë njerëzit e punës.


Denaj e lidhi këtë progres me vizionin për një Shqipëri që prodhon, eksporton dhe afrohet çdo ditë e më shumë me Bashkimin Europian, duke e pozicionuar bujqësinë si një nga shtyllat kryesore të zhvillimit ekonomik dhe integritimit europian.

Produktet bujqësore shqiptare janë tashmë të pranishme në tregjet e BE-së, rajonit dhe më gjerë, me eksporte të përqendruara kryesisht në fruta-perime, bimë mjekësore

dhe prodhime të përpunuara.

Me gjithë progresin, sektori vijon të përballet me sfida si copëzimi i tokës bujqësore, mungesa e mekanizimit modern, ndikimi i ndryshimeve klimatike dhe mungesa e fuqisë punëtore në zonat rurale.

Për të arritur objektivin ambicioz të 1 miliardë eurove deri në vitin 2030, do të nevojiten politika më të thelluara për modernizimin e infrastrukturës agrare, sigurinë ushqimore dhe përmirësimin e qasjes në tregjet ndërkombëtare.



Shqipëri - Kosovë, bashkëpunim për mbrojtjen e të drejtave të punëtorëve

Shqipëria dhe Kosova nënshkruan një memorandum mirëkuptimi për forcimin e bashkëpunimit rajonal në fushën e inspektimit të punës dhe mbrojtjes së të drejtave të punëtorëve.

e zbatimit të ligjeve të punës, përmirësimit të sigurisë në vendin e punës dhe mbrojtjes së të drejtave të punëtorëve, duke përfshirë punëtorët migrantë dhe grupet e marginalizuara

bashkëta ose të bashkërenduara, shkëmbimin e informacionit përmes protokolleve të qarta ndërinstytucionale, si dhe nisma ndërgjegjëse për punëdhënësit dhe punëmarrësit mbi të drejtat dhe detyrimet ligjore.

Një tjetër aspekt i rëndësishëm i bashkëpunimit është forcimi i kapaciteteve institucionale dhe profesionale të inspektorateve të punës në Shqipëri dhe Kosovë, duke përfshirë trajnimin dhe mbështetjen për inspektorët e punës në të dy vendet.

Ky bashkëpunim, i mbështetur nga partnerët e GIZ, është një shembull i qartë i unitetit rajonal në promovimin e praktikave të sigurta dhe të drejta të punës, duke krijuar baza për përmirësimin e qëndrueshmërisë në qeverisjen e tregut të punës në Shqipëri dhe Kosovë.



Ky angazhim i përbashkët synon ndërtimin e një kuadri të koordinuar për sigurimin

në të dy vendet.

Marrëveshja parashikon zhvillimin e inspektimeve të pë

Shqipëri-BE, mbahet në Bruksel Konferenca V Ndërqeveritare - Hapet grupkapitulli i ‘Konkurrueshmërisë’

U mbajt në Bruksel Konferenca e pestë ndërqeveritare Shqipëri-Bashkimi Europian. Delegacioni shqiptar do të kryesohet nga Ministri për Evropën dhe Punët e Jashtme, Igli Hasani. Takimi do të shërbejë për hapjen e grupkapitullit të tretë në procesin e negociatave që ka të bëjë me "Konkurrueshmërinë dhe Rritjen Gjithëpërfshirëse".

Ky grupim i tretë përfaqëson përfshin të fusha negocimi që janë:

- Kapitulli 10 (Transformimi Digjital dhe Media)
- Kapitulli 16 (Tatimet)
- Kapitulli 17 (Politika Ekonomike dhe Monetare)
- Kapitulli 19 (Politika Sociale dhe Punësimi)
- Kapitulli 20 (Ndërmarrjet dhe Politika Industriale)
- Kapitulli 25 (Shkenca dhe Kërkimi)
- Kapitulli 26 (Arsimi dhe Kultura)
- Kapitulli 29 (Bashkimi Doganor)

Përparimi në këto fusha është thelbësor për të garantuar

stabilitetin fiskal të Shqipërisë, modernizimin industrial, rritjen

që u mbajt në Luksemburg. Ecja me ritëm të përshepe-



e inovacionit, përmirësimin e kushteve të punës dhe pjesëmarrjen në iniciativat evropiane të kërkimit shkencor, arsimin dhe digjitalizimit.

Ky është grup kapitulli i katërt që hapet në procesin e negocimit. Grupimi i parë, ai themelor u hap më 15 tetor 2024, Grupimi i gjashtë për Marrëdhëniet me Jashtë u hap më 17 Dhjetor 2024, ndërsa Grupimi i dytë, Tregu i Brendshëm, u hap më 14 Prill 2025, gjatë konferencës së katërt ndërqeveritare

jtuar në procesin e negociatave reflekton si përkushtimin e Shqipërisë ndaj reformave, ashtu edhe theksin e ripërtërit të BE-së mbi zgjerimin si një prioritet strategjik.

Përfundimi me sukses i negociatave pritet të sjellë përmirësime të ndjeshme në jetën e qytetarëve shqiptarë, si shërbime publike më të thjeshta dhe transparente, politika tatimore më të drejta të prirura për t'u bërë pjesë e tregut të vetëm të BE-së.

Denaj në takimin rajonal të FAO: Modernizim dhe qëndrueshmëri në sektorin agroushqimor

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Anila Denaj, mori pjesë në takimin për Konsultimin Informal të Organizatës së Ushqimit dhe Bujqësisë së Kombeve të Bashkuara

Ky takim, i cili shërben si përparim për sesionin e 35-të të Konferencës Rajonale për Evropën, mbledhi përfaqësues nga vendet anëtare për të ndarë përvoja dhe ide mbi përparimin

Ministria Denaj, gjatë takimit theksoi se u diskutua gjerësisht mbi sfidat dhe mundësitë që po përjetojnë vendet e rajonit, prioritetet për periudhën 2026-2027, rolin e komisioneve teknike dhe qasjet e reja për transformimin e sistemeve agroushqimore, të cilat qëndrojnë në qendër të agjendës së zhvillimit të qëndrueshëm.

Ajo nënvizoi rëndësinë e bashkëpunimit me FAO në fuqizimin e politikave kombëtare për bujqësinë dhe zhvillimin rural, duke shtuar se Shqipëria mbetet e angazhuar për modernizimin dhe qëndrueshmërinë e sektorit agroushqimor, si pjesë e përpjekjeve të saj për t'u afruar me standardet e Bashkimit Europian.

“FAO, me një histori 80-vjeçare, mbetet një partner strategjik për Shqipërinë, veçanërisht në çështje që lidhen me menaxhimin e burimeve natyrore dhe përballimin e ndryshimeve klimatike”, u shpreh Denaj.

Takimi rajonal vjen në një kohë kur vendet po përballen me sfida komplekse të lidhura me sigurinë ushqimore, ndotjen mjedisore dhe efektet e krizave globale, duke e bërë bashkëpunimin rajonal dhe ndërkombëtar më të domosdoshëm se kurrë më parë.



(FAO) për Evropën dhe Azinë Qendrore.

drejt Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ).

SI TË SHMANGNI REFUZIMET NË KUFIRIN E BE-SË

SI TË HYNI NË TREGUN E BE-SË ME BIMËT TUAJA: RËNDËSIA E SIGURISË USHQIMORE DHE HIGJENËS PËR EKSPORTUESIT SHQIPTARË TË BAM

Organizata e Kombeve të Bashkuara për Zhvillim Industrial (UNIDO), përmes Programit Global për Cilësi dhe Standarde (GQSP), të mbështetur nga Qeveria Zvicerane përmes Sekretariatit Shtetëror për Çështjet Ekonomike (SECO), po mbështet fermerët dhe ndërmarrjet e vogla e të mesme (NVM) në përmbushjen e standardeve të kërkuara, duke lehtësuar aksesin e tyre në tregjet evropiane dhe ndërkombëtare

Për kë është ky artikull?

Fermerë, përpunues dhe eksportues të bimëve aromatike dhe mjekësore (BAM) që duan të sigurojnë përputhshmëri me kërkesat e sigurisë ushqimore në Bashkimin Evropian.

Eksporti i bimëve aromatike dhe mjekësore (BAM) drejt tregut të Bashkimit Evropian është një mundësi e artë për fermerët dhe përpunuesit shqiptarë. Por kjo mundësi vjen e shoqëruar me përgjegjësi të madhe: respektimin rigoroz të standardeve të sigurisë ushqimore dhe higjienës. Mosrespektimi i këtyre standardeve mund të sjellë pasoja serioze – që nga refuzimi i mallit në kufijtë e BE-së, deri te humbjet financiare dhe dëmtimi i reputacionit të sektorit. Në vitet e fundit janë regjistruar raste të përsëritura ku eksportet shqiptare të BAM janë refuzuar pikërisht për shkak të problemeve të sigurisë ushqimore, duke shkaktuar humbje të ndjeshme për tregtarët dhe vetë fermerët. BE-ja ka një sistem vigjilent kontrolli (RASFF) që i evidenton dhe i shpërndan menjëherë këto raste tek të gjitha vendet anëtare, gjë që mund të ndikojë negativisht tek besimi i blerësve të huaj ndaj produkteve tona.

Në këtë artikull do të trajtojmë pikërisht rëndësinë e këtyre standardeve dhe mënyrat praktike se si sektorët e BAM mund të përmbushin kërkesat e BE-së. Do të shpjegojmë kategoritë kryesore të standardeve të sigurisë ushqimore në BE, rolin e sistemit HACCP (Analiza e Rreziqeve dhe Pikave Kritike të Kontrollit) dhe pse ai është i detyrueshëm, metodat e sigurta për sterilizimin e produkteve të thata bi-more (me fokus të veçantë tek trajtimi me avull), si dhe do të japim këshilla praktike për të shmangur refuzimet në kufi. Gjithashtu, do të shqyrtojmë se çfarë ndodh kur aktivizohet sistemi RASFF dhe si ndikon kjo tek eksportuesit shqiptarë, duke sjellë shembuj konkretë nga përvoja e viteve të fundit (p.sh. refuzime të ngarkesave me sherebelë apo rigon, si dhe përfitimet e vërejtura nga përdorimi i trajtimeve me avull).

Rëndësia e Sigurisë Ushqimore për Eksportet në BE

Siguria ushqimore nuk është thjesht një kërkesë burokratike – ajo është parakusht i suksesit në tregun e BE-së. Vendet e BE-së kanë standarde nga më të lartat në botë për mbrojtjen e shëndetit të konsumatorit, dhe çdo produkt importi kontrollohet imtësisht.

Siguria ushqimore është një nga kushtet më të rrepta për eksport drejt BE-së.

Mosrespektimi i kërkesave:

• Çon në refuzim të menjëhershëm të ngarkesës në kufi

• Mund të aktivizojë sistemin e alarmit RASFF

• Përkeqëson reputacionin e eksportuesit dhe vendit të origjinës

Nëse gjatë kontrolleve kufitare një dërgesë rezulton jashtë standardeve (p.sh. zbulohen pesticide mbi normë, ndotës kimikë, mikroorganizma të rrezikshëm, etj.), ajo dërgesë mund të **refuzohet menjëherë**. Kjo nënkupton kosto të mëdha: humbje e mallit (i cili mund të asgjësohet ose kthehet mbrapsht me shpenzimet tuaja), humbje financiare nga porosia e paplotësuar, dhe dëmtim i marrëdhënieve me blerësin. Për më tepër, çdo rast i tillë evidentohet në **Sistemin e Alarmit të Shpejtë për Ushqim dhe Ushqim për Kafshë (RASFF)** të BE-së, duke vënë në dijeni të gjitha vendet anëtare për problemin. Me fjalë të tjera, një problem në një shtet të BE-së bëhet menjëherë i ditur në të gjithë BE-në.

Për shembull, gjatë periudhës 2019-2025, sistemi RASFF regjistroi **69 raste alarmi** për produktet ushqimore të eksportuara nga Shqipëria. Ndër këto, 9 raste lidhen drejtpërdrejt me eksportet e bimëve mjekësore dhe erëzave (BAM), të cilat klasifikoheshin si probleme serioze ose me rrezik të mundshëm. Këto shifra tregojnë se sektori ynë ende përballlet me sfida në përmbushjen e standardeve. Çdo **refuzim** ose **alarm RASFF** shoqërohet me **humbje financiare**

dhe **goditje për imazhin** e kompanive tona eksportuese. Përveç kësaj, edhe fermerët në fillim të zinxhirit pësojnë, pasi produkti i mundit të tyre mbetet pa u shitur. Prandaj, **parandalimi** i këtyre situatave është jetik. Një produkt i sigurt dhe me cilësi ngarkon besimin e blerësve dhe hap rrugën për zgjerimin në tregjet e huaja, ndërsa një produkt me probleme mund të mbyllë dyert për një kohë të gjatë.

Nga ana tjetër, po rritet vetëdija e konsumatorëve (si jashtë, edhe brenda vendit) mbi rëndësinë e sigurisë ushqimore dhe cilësisë. Kjo do të thotë se prodhuesit dhe eksportuesit shqiptarë duhet të jenë një hap para: të sigurojnë që çdo bimë aromatike, erëz apo produkt medicinal që përgatitet për eksport plotëson standardet ligjore dhe madje tejkalon pritshmëritë bazë. Vetëm kështu mund të ndërtojmë një **reputacion të qëndrueshëm** si furnizues seriozë e cilësorë në BE.

Kategoritë Kryesore të Standardeve të Sigurisë Ushqimore në BE

Kur flasim për **kërkesat e BE-së për sigurinë ushqimore**, kemi të bëjmë me një gamë të gjerë rregullash dhe udhëzimesh. Në mënyrë të thjeshtuar, ato mund të ndahen në disa **kategori kryesore** që eksportuesit e BAM duhet t'i kenë parasysh:

Çfarë përfshijnë standardet e sigurisë ushqimore në BE?	
Kategoria	Përshkrimi
Higjiena	Praktika të pastra pune, përdorim i ujit të pastër, veshje mbrojtëse për stafin
Ndotësit	Metale të rënda, mykotoksina, alkaloidë pirolizidine – të pranishme veçanërisht në BAM të egra
MRL – Mbetjet e pesticideve	Kufij maksimalë për çdo substancë; kërkohet përdorimi i pesticideve të aprovuara nga BE
Rreziqe mikrobiologjike	Prania e Salmonella apo E. coli për shkak të tharjes ose magazinimit të papërshtatshëm
Trupa të huaj	Gurë, insekte, copa plastike, qelq – nuk ka kufij të përcaktuar por refuzohen rreptësisht

• **Higjiena Ushqimore** – Kërkesat bazë të higjienës gjatë të gjithë zinxhirit prodhues, nga fusha apo mali ku mbledhet bima, deri tek magazinimi, përpunimi dhe ambalazhimi. Këtu përfshihet higjiena personale e punëtorëve, pastërtia e ambienteve dhe pajisjeve, uji i pijshëm në proces, mbrojtja e produktit nga ndotjet gjatë tharjes apo ruajtjes, etj. Qëllimi është që produkti të mos kontaminohet në asnjë hap të rrugës “nga ferma tek piruni”.

• **Ndotësit Kimikë (Kontaminantët)** – Substanca të dëmshme që mund të gjenden në produkte si rezultat i mjedisit ose trajtimeve jo të duhura. Këtu hyjnë metalet e rënda (p.sh. plumbi, kadmiumi), ndotës nga mjedisi apo paketimi (p.sh. hidrokarburet, dioksinat), **toksinat natyrore** si mikotoksinat (toksina nga myqet), apo alkaloidë toksikë që mund të vijnë nga përzierja e pavullnetshme e bimëve të padëshiruara. BE-ja ka vendosur kufij maksimalë për shumë ndotës të tillë (p.sh. Rregullorja (KE) Nr. 1881/2006 përcakton kufijtë maksimalë për kontaminantë të caktuar në ushqime). Parimi është që niveli i ndotësve të mbahet sa më i ulët që është arritshëm, duke zbatuar praktikën e mira bujqësore e prodhuese. Në rastin e BAM, kjo nënkupton p.sh. shmangien e tharjes së bimëve në afërsi të rrugëve me pluhur (për të shmangur plumbin nga karburanti), ose kujdesin që gjatë grumbullimit të bimëve të egra të mos përfshihen gabimisht bimë helmuese (si **Datura** apo **Senecio** që lëshojnë alkaloidë toksikë).

• **Mbetjet e Pesticideve (MRL)** – *Maximum Residue Levels* (Niveli i Maksimumit të Mbetjeve) janë kufijtë e lejuar të mbetjeve të pesticideve në ose mbi produktet ushqimore. Edhe pse shumë nga bimët tona mbledhen në natyrë të egër dhe janë organike, për ato që kultivohen, përdorimi i pesticideve duhet kontrolluar me kujdes. BE-ja ka një bazë të dhënash ku përcakton MRL-të për çdo kombinim produkt-pesticid. Për shembull, rigoni, sherebela apo livan-

doja duhet të mos kenë mbetje pesticide mbi një prag të caktuar (zakonisht pragu është shumë i ulët, shpesh në nivel gjurmësh). Është e rëndësishme të përdoren vetëm pesticide të lejuara dhe sipas dozave e afateve të rekomanduara, në mënyrë që në kohën e korjes, mbetjet të jenë nën kufirin e lejuar. Shkeljet në këtë aspekt janë ndër shkaqet më të shpeshta të alarmeve ushqimore. Megjithëse Ministria e Bujqësisë raporton se rastet e tejkalimit të pesticideve në eksportet e Shqipërisë janë të pakta në raport me volumin total, përdorimi i tepruar ose i pesticideve të ndaluara mbetet një shqetësim madhor për ekspertët.

• **Rreziqet Mikrobiologjike** – Këtu flasim për mikroorganizma të dëmshëm si bakteret patogjene (p.sh. **Salmonella**, **E. coli** shigatoksigjene, **Listeria**), myqet që prodhojnë toksina, apo edhe viruset e lidhura me ushqimin. Erëzat dhe bimët e thata konsiderohen produkte me lagështi të ulët, por kjo nuk i bën imunë ndaj rreziqeve mikrobiologjike. **Salmonella** sidomos është identifikuar si rrezik në erëza dhe bimë medicinale të thata, pasi mund të mbijetojë për kohë të gjatë në produkte të thatë. Nëse produktet thahen në ambient të hapur dhe bie ndonjë papastërti (p.sh. feçe zogjsh apo kafshësh), bakteret mund të kontaminojnë gjethet. Po ashtu, niveli i lartë i lagështisë gjatë ruajtjes mund të nxisë zhvillimin e myqeve. BE-ja ka **kritere mikrobiologjike** strikte (p.sh. Rregullorja (KE) Nr. 2073/2005) – për shembull, kërkohet që **Salmonella** të jetë e munguar në 25 gram produkt. Pra, edhe një gjurmë e Salmonelës mjafton për ta cilësuar ngarkesën të pasigurt. Një ngarkesë me bimë të thata e kontaminuar me Salmonella do të refuzohet pa hezitim, meqenëse këto produkte konsumohen pa ndonjë proces gatimi që do të vriste bakterin.

• **Trupat e Huaj (materiale të huaja)** – Kjo kategori shpesh nënvlerësohet, por është po aq e rëndësishme. Trupa të huaj quajmë çdo material që s’duhet të jetë në produkt: gurë të vegjël, thërime qelqi, copa plastike, pjesë insektesh, ashkla druri, madje edhe pluhur e dhe. Duke qenë se shumë bimë mbledhen në natyrë dhe thahen në ambiente gjysmë të hapura, ekziston rreziku i pranisë së trupave të huaj. Gjithashtu, gjatë grirjes apo sitjes mund të ketë copa metali nga makineritë. BE-ja kërkon **kontroll rigoroz** për këto – kompanitë serioze përdorin **pajisje pastrimi**, sita dhe deri **detektorë metali** për të eliminuar çdo send të huaj para paketimit. Një konsumator evropian që gjen një gurë apo insekt në çajin bimor do ta humbasë besimin te produkti. Më keq akoma, nëse zbulohen trupa të huaj gjatë kontrollit në kufi, e gjithë sasia mund të ndalohet. Kontaminimi i tillë bie edhe ndesh me kërkesat fitosanitare (sepse trupa të huaj mund të përfshijnë insekte karantinë ose papastërti të tjera).

Duke mbajtur parasysh këto kategori kryesore, eksportuesit e BAM mund të krijojnë një **listë kontrolli** për produktet e tyre. Çdo kategori përmban kërkesa ligjore specifike, por edhe **praktika të mira** vullnetare që ia vlejnë të zbatohen. Në thelb, produkti ynë duhet të jetë i **pastër**, i **sigurt**, **pa kimikate të dëmshme**, **pa baktere patogjene**, dhe **pa papastërti fizike**. Kjo siguri duhet të garantohet që në vendin e origjinës, përpara se produkti të niset jashtë kufijve.

HACCP – Sistemi i Detyrueshëm për Sigurinë Ushqimore

Një nga mjetet më të rëndësishme për të siguruar që asnjë nga rreziqet e lartpërmendura të mos kompromentojë produktin tuaj është zbatimi i sistemit **HACCP (Hazard Analysis and Critical Control Points)**, në shqip: *Analiza e Rreziqeve dhe Pikave Kritike të Kontrollit*. Ky sistem është një qasje parandaluese ndaj sigurisë ushqimore – në vend që të presim të zbulojmë një problem në fund (p.sh. kur kamioni mbërrin në Itali), HACCP na udhëzon të identifikojmë **përpara** se ku mund të shfaqen problemet gjatë prodhimit dhe përpunimit dhe të vendosim kontrolle për t'i parandaluar ato.

Si të Hyni në Tregun e BE-së me Bimët Tuaja: Rëndësia e Sigurisë Ushqimore dhe Higjienës për Eksportuesit Shqiptarë të BAM

(Vijon nga faqja 3)

Çfarë është HACCP dhe pse është e detyrueshme?

HACCP (Analiza e Rreziqeve dhe Pikat Kritike të Kontrollit) është një metodë që parandalon problemet para se të ndodhin.

Analizon rreziqet në çdo hap të procesit: tharje, pastrim, paketim

Kërkohet nga ligji i BE – Reg. (EC) 853/2004

Nuk është e nevojshme të jesh i certifikuar, por zbatimi dhe dokumentimi janë të domosdoshëm

Këshillë praktike:

Për BAM, një plan i thjeshtuar HACCP që mbulon pikat kyçe si tharja, magazinimi dhe kontrolli i ndotjeve mjafton për të treguar përputhshmëri.

Pse është i detyrueshëm HACCP? Legjislacioni i BE-së (dhe ai shqiptar, i harmonizuar me të) kërkon që të gjithë operatorët e ushqimit – përfshirë përpunuesit dhe eksportuesit e bimëve medicinale/aromatike – të zbatojnë parimet e HACCP në aktivitetin e tyre. Kjo do të thotë, çdo punishte, fabrikë grumbullimi apo fabrike paketimi duhet të ketë një plan HACCP. Në fakt, për eksportuesit kjo konsiderohet **parakusht** ligjor për t'u lejuar në treg. Autoritetet mund ta verifikojnë zbatimin e HACCP-it nëpërmjet inspeksioneve dhe kontrolleve të dokumentacionit apo analizave laboratorike (p.sh. nëse produkti del pa mikroorganizma, pa trupa të huaj, atëherë nënkuptohet që pikat kritike janë menaxhuar siç duhet).

Ja çfarë nënkupton në praktikë HACCP për një operator në sektorin e BAM:


- Identifikimi i rreziqeve:** Filloni duke hartuar gjithë procesin tuaj, nga mbledhja e bimës, trajtimi, tharja, magazinimi, pastrimi, deri te paketimi final. Për secilën hallkë, pyesni veten: *“Çfarë mund të shkojë keq këtu që do ta bënte produktin të pasigurt?”*. Për shembull, gjatë tharjes në diell – *a ka rrezik që shpendët të ndotin produktin?* Gjatë magazinimit – *a mund të shfaqen minj apo insekte?* Gjatë grirjes – *a mund të bien copa metali nga makineria?* Gjatë kultivimit – *a po përdoren pesticide?* e kështu me radhë.

- Përcaktimi i Pikave Kritike të Kontrollit (CCP):** Nga rreziqet që identifikuat, përcaktoni cilat janë pikat më kritike ku duhet kontroll patjetër. P.sh., faza e pastrimit përpara paketimit mund të jetë një CCP për trupat e huaj – këtu ju duhet të siguroheni (me sitje, fryrje, detektor metali, inspektim vizual) që në produkt s'ka mbetur gjë e huaj. Ose, sterilizimi me avull (nëse e përdorni) është CCP për mikroorganizmat – aty siguroheni që temperatura/avulli të arrijë nivelin për eliminimin e baktereve. Një CCP tjetër mund të jetë kontrolli për lagështinë përpara ruajtjes (nëse lagështia e gjetheve të thara bie nën X%, nuk zhvillohen myqet).

- Vendosja e masave kontrolluese dhe monitorimi:** Për secilën CCP, vendosni **kuftime** (p.sh. “lagështia duhet të jetë ≤12%”), mënyrën si do ta arrini (p.sh. duke tharë X orë) dhe si do ta matni/monitoroni (p.sh. me higrometër). Nëse ka devijim – p.sh. në monitorim vini re se lagështia është 14% – atëherë duhet të keni procedura korigjuese (p.sh. rifilloni tharjen ose përhapni produktin për ventilim). Monitorimi duhet të dokumentohet: mbani **regjistër** ku shënoni datat, rezultatet e matjeve, dhe veprimet korigjuese kur është e nevojshme.

- Dokumentimi dhe gjurmueshmëria:** Mbani shënim çdo hap. HACCP kërkon shumë dokumente, por kjo ju mbron si ju ashtu edhe konsumatorin. Nëse diçka ndodh, mund të gjeni shpejt burimin. Për shembull, mbani regjistër të lotit të produktit, nga cili fermer apo parcelë erdhi, çfarë trajtimesh iu bënë. Kjo ndihmon jashtë mase në rast se (larg qoftë) një analizë në Evropë gjen një problem – ju mund të gjurmoni mallin dhe të izoloni pjesën e kontaminuar.

Duhet theksuar se **zbatimi i HACCP është i detyrueshëm, por certifikimi i tij nuk është**. Pra, ju nuk keni detyrim të keni një certifikatë HACCP të lëshuar nga ndonjë organizëm (ajo është vullnetare), por ama duhet të keni realisht sistemin në funksionim. Shumë kompani shqiptare tashmë e kanë kuptuar vlerën e kësaj: në një studim të fundit, rreth 20% e kompanive të anketuara në sektor kishin marrë edhe certifikatë formale HACCP – kjo tregon përkushtimin drejt sigurisë. Mirëpo, edhe nëse jeni i vogël dhe s'keni mundësi certifikimi, **implementimi** i primeve HACCP është ende i domosdoshëm dhe mund ta bëni vetë me përkushtim, ndjekje të udhëzimeve të ekspertëve ose manualeve të thjeshtëzuara.



Sterilizimi i Bimëve Aromatike të Thata – Fokusi te Avulli

Një nga sfidat kryesore për eksportuesit e BAM është **ulja e ngarkesës mikrobike** (bakteret, myqet) në nivel të sigurt pa dëmtuar cilësinë e produktit. Bimët e egra mund të kenë mikroorganizma nga natyra; ndërsa gjatë procesit të tharjes dhe magazinimit, mund të ketë kontaminim shtesë. Importuesit evropianë, sidomos ata që përdorin këto bimë në produkte ushqimore (çaje, erëza për gatim, suplemente), shpesh **kërkojnë që produkti të jetë sterilizuar ose të ketë një numër shumë të ulët mikroorganizmash**. Si mund ta arrijmë këtë?

Metoda	Statusi në BE
Avulli (Steam)	✓ E pranueshme dhe e rekomanduar
Rrezatimi	⚠ Ligjërisht i lejuar, por jo i pëlyqeshëm për konsumatorët
Tymosja me substanca të ndaluara (p.sh. metil bromid)	⊗ Rreptësisht e ndaluar

Kujdes: Disa raste refuzimesh kanë ndodhur për BAM të trajtuara me okside etileni apo për mbetje të larta të pesticideve.

Metodat kryesore për **dezinfektimin/sterilizimin** e erëzave dhe bimëve të thara janë: **trajtimi me avull**, trajtimi me gaze kimike, apo rrezatimi (irradimi) me reze gama/UV. Nga këto, **avulli (steam sterilization)** është metoda më e pranuar dhe e sigurt për produktet organike dhe natyrore. Në këtë proces, produktet ekspozohen ndaj avullit me temperaturë të lartë për një kohë të caktuar, zakonisht nën presion të kontrolluar. **Avulli i nxehtë vret bakteret, viruset dhe myqet**, por nëse aplikohet si duhet, **nuk ndikon negativisht në cilësinë e bimës** – aroma, shija dhe ngjyra mbeten thuajse të pandryshuara. Kjo është shumë e rëndësishme për BAM, sepse fuqia e tyre qëndron pikërisht tek aroma dhe principi aktiv. Studimet kanë treguar që sterilizimi me avull, kur bëhet në parametrat e duhur, e bën produktin **më të sigurt për konsum** pa pasur efekte anësore organoleptike (pra, pa prishur shijen, erën apo pamjen). Duhet vetëm kujdes që parametra si temperatura dhe lagështia të kontrollohen – për shembull, për disa bimë shumë të ndjeshme, avulli mund të reduktojë pak përmbajtjen e vajrave esencialë, prandaj programet e sterilizimit duhen përshtatur për secilën kulturë.

Pse BE-ja këmbëngul tek avulli? Sepse në të kaluarën, një metodë tjetër për të sterilizuar erëzat ka qenë **fumigimi me oksid etileni (ethylene oxide - ETO)**, një gaz kimik që vret mikrobet. Mirëpo, ETO është **kancerogjen** dhe lë mbetje toksike në produkt. Kjo metodë është e ndaluar në BE për produktet ushqimore, dhe nëse gjurmë të saj zbulohen, produkti shpallet i pasigurt. Një skandal i madh ndodhi pak vite më parë kur **qindra ngarkesa me fara susami** nga Azia u tërhoqën nga tregu evropian për shkak të mbetjeve të oksidit të etilenit. Ky shembull tregon se **gazit ose kimikateve toksike nuk kanë vend** në përpunimin e produkteve ushqimore që ne eksportojmë.

Sa i takon **rrezatimit**, BE-ja e lejon në parim trajtimin me rrezatim jonizues për erëzat (disa shtete e praktikojnë në erëza si piper i zi, për të eliminuar patogjenët), por produkti i trajtuar me rrezatim **duhet të etiketohet** si i tillë. Shumë konsumatorë e shohin me dyshim ushqimin e trajtuar me

rrezatim, ndaj kjo metodë nuk është shumë popullore për produktet organike si BAM.

Prandaj, **zgjidhja më e mirë mbetet avulli**. Sot në Shqipëri disa prej kompanive kryesore eksportuese kanë investuar në **linja sterilizimi me avull** ose i dërgojnë produktet për sterilizim në impiante të posaçme (në vend ose jashtë). Kjo iu ka mundësuar atyre të **ulin ngarkesën bakteriale** nën kufijtë e kërkuar nga BE dhe klientët e tyre. Avulli depërton në brendësi të gjetheve/produktit dhe asgjëson sporet dhe bakteret patogjene. Është një proces miqësor me mjedisin (përdor vetëm ujë dhe nxehtësi, pa kimikate) dhe i pranueshëm edhe për produktet organike.

Natyrisht, instalimi i një pajisjeje avulli kërkon investim të konsiderueshëm dhe sasi të mëdha produkti për ta justifikuar ekonomikisht. Për fermerët apo grumbulluesit e vegjël, zgjidhja mund të jetë **bashkëpunimi**: p.sh., të shfrytëzojnë qendrat e përpunimit që ofrojnë shërbimin e trajtimit me avull kundrejt pagesës, ose të bashkohen disa së bashku për të ngritur një njësi të tillë. Disa projekte zhvillimi në Shqipëri kanë mbështetur pajisjen e operatorëve me teknologji të tillë, duke forcuar kapacitetet e sektorit.

Në përfundim: nëse produktet tuaja (p.sh. gjethe sherebele, rigoni, trumza) janë **vizualisht të pastra** dhe **kimikisht të sigurt**, një trajtim final me avull mund të jetë “vula” e sigurisë mikrobiologjike. Kështu, ju dërgoni në BE një produkt që plotëson **të gjitha kriteret** – dhe praktikisht eliminoni mundësinë e refuzimit për shkak të Salmonelës apo patogjenëve të tjerë.

Si të shmangni refuzimet në kufi?

- ✓ Përdorni vetëm pesticide të miratuara në BE dhe kontrolloni MRL për çdo lot
- ✓ Zbatoni praktika higjienë dhe regjistra HACCP në të gjitha fazat
- ✓ Sterilizoni me avull, jo me kimikate të ndaluara
- ✓ Bëni kontrollin vizual dhe mekanik për trupa të huaj para eksportit
- ✓ Mbani analizat laboratorike për çdo lot të eksportuar
- ✓ Sigurohuni që produkti të jetë i pastër fizikisht dhe i sigurt mikrobiologjikisht

Çfarë ndodh nëse aktivizohet sistemi RASFF?

Nëse një produkt BAM nga Shqipëria rezulton jo i sigurt në një vend të BE-së:



Kjo sjell **kosto më të larta**, vonesa dhe ndikon **negativisht në reputacionin** e të gjithë sektorit.

Trajtimi me avull – një histori suksesi

Një kompani eksportuese e bimëve mjekësore në Shqipëri vendosi të blejë një pajisje moderne për trajtimin me avull, me kapacitet disa qindra kilogramë në orë. Fillimisht, ky investim u duk i madh, por shumë shpejt kompania arriti të hyjë në tregje premium që më parë ishin të paarrtshme. Për shembull, ata filluan t'i shesin rigonin një blerësi që furnizon zinxhirë supermarketes në BE. Kushti i blerësit ishte: **produkti duhet të jetë i sterilizuar dhe me certifikatë mikrobiologjike**. Kompania e plotësoi këtë kusht falë pajisjes me avull dhe tashmë rigoni i tyre gjendet në raftet e supermarketeve evropiane si produkt me cilësi të lartë. Krahës kësaj, ata ofruan shërbimin e sterilizimit edhe për eksportues të tjerë më të vegjël në vend.

Rezultati: jo vetëm fitim për vete, por edhe një shërbim i ri në vend që rrit vlerën e shtuar të BAM shqiptar (më parë, shumë herë duhej dërguar malli në Itali për t'u sterilizuar, ndërsa tani mund të bëhet në Shqipëri).

BUJQËSI

Blegtoria, interes i lartë për subvencionet, mbi 3200 fermerë kanë aplikuar në skemat mbështetëse

Blegtoria po shndërrohet në një nga sektorët më të suksesshëm dhe rentabël në qarkun e Shkodrës. Specialistë të fushës theksojnë se skemat subvencioneve që funksionojnë prej disa vitesh kanë ndikuar dukshëm në rritjen e numrit të krerëve të bagëtive dhe në krijimin e fermave të mëdha në këtë zonë.

“Shumë fermerë blegtor janë joshur nga subvencionet. Tani i marrin çdo vit. Janë ndërgjegjësuar që duhen krerë të matrikuluara, dokumentacione të tjera, sigurime të paguara. Po shtojnë numrin e krerëve, po bëhen ferma më të mëdha”, tha Sherif Brahaj, specialist AREB Shkodër.

Një ndër masat shtesë ne skemën e subvencioneve të qeverisë për këtë vit është mbështetja për blegtorët që rri-

sin viça për majmëri. Kjo masë ka nxitur interes, duke rritur

aplikimit në skemat e subvencionve për bujqësinë dhe bleg-



të mëdha në këtë zonë. Sektor atraktiv dhe sektor e rentabël

numrin e blegtorëve nga qarku i Shkodrës që kanë aplikuar deri tani për të përfituar nga subvencionet.

Ndërkohë që kanë mbetur gati tri javë nga mbyllja e procesit të

torinë, deri më tani, mbi 3200 fermerë nga qarku i Shkodrës kanë realizuar aplikimet e tyre, shumica e të cilëve kanë treguar interes të veçantë për skemën mbështetëse të naftës.

Ibrahimaj: Rritja e ekonomisë, historike krijimi i Bankës Kombëtare të Zhvillimit

Ministria e Shtetit për Sipërmarrjen dhe Klimën e Biznesit, Delina Ibrahimaj, mori pjesë në Konferencën Ndërkombëtare mbi Ekonomitë e Vendeve të Ballkanit dhe Evropës Lindore (EBEEC 2025), organizuar në Tiranë.

Ibrahimaj tha se, qeveria ka tashmë vizion të qartë, për një zhvillim ekonomik më të qëndrueshëm, gjithëpërfshirës dhe konkurrues, teksa vuri në dukje se, gjatë takimit u diskutua mbi sfidat strukturore që përballojnë ekonomitë e rajonit, si dhe rëndësinë e ndërtimit të institucioneve që orientojnë rritjen drejt të ardhmes.

Në këtë kuadër, Ibrahimaj, prezantoi gjetjet e studimit e saj mbi rolin e bankave të zhvillimit në tërheqjen e kapitalit ndërkombëtar dhe nxitjen e rritjes ekonomike, një temë që lidhet drejtpërdrejt me

vendimin historik për të krijuar për herë të parë Bankën

europiane për zhvillim afatgjatë”, deklaroi Ibrahimaj.



Kombëtare të Zhvillimit në Shqipëri.

“Ky institucion i ri do të mbështesë sektorët strategjikë si bujqësia, SME-të dhe inovacioni, duke përmirësuar aksesin në financa dhe duke forcuar kapacitetin tonë për të përthithur më shumë fonde

EBEEC 2025 mbledhi bashkë akademikë, liderë të industrisë, studiues, studentë, organe qeveritare dhe organizata joqeveritare, që prezantuan rrugë të reja për diskutime të frytshme dhe gjetjen e zgjidhjeve inovative me ndikim në ekonomi.

AZHBR mbështet mbi 4 mijë bletarë për rritjen e prodhimit të mjaltit

Agjencia për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural, bën të ditur se, mbështetja për bletarinë vijon edhe gjatë vitit 2025 përmes Skemës Kombëtare, me synim zhvillimin afatgjatë të sektorit.

Sot bletaria është kthyer në një ‘industri më vete’, sa i takon kontributit dhe zhvillimit që po merr, duke u shtrirë në të gjithë vendin dhe në numër është trefishuar këto 20 vitet e fundit, si nga tradita e pasioni dhe rritja e të ardhurave.

Në Ditën Botërore të Bletëve, Agjencia për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural, (AZHBR) informon se, gjatë vitit 2024, përmes Skemës Kombëtare, ka mbështetur 4,056 bletarë në zgjerimin e koshereve dhe rritjen e prodhimit vendas të mjaltit.

Sipas AZHBR, financimi i drejtpërdrejtë i bletarëve, përmes subvencioneve ka forcuar rolin e bletarisë në zinxhirin ushqimor kombëtar.

Bletaria është një sektor

strategjik për mbrojtjen e biodiversitetit dhe sigurimin e ushqimit të qëndrueshëm.

Në Shqipëri, ky sektor ka njohur zhvillim të vazhdueshëm, duke kontribuar në përmirësimin e ekonomisë dhe ekosistemit.

Sot numërohen rreth 500,000 zgjoje bletësh në të gjithë vendin, ku vetëm në 10 vitet e fundit numri i zgjojeve është rritur me 64 %, duke ndikuar ndjeshëm në nivelin e prodhimit të mjaltit për tregun dhe për eksport.

Kultivimi i grurit, bashkëpunim me QTTB Lushnjë për përzgjedhjen e kultivarëve që japin rendiment

Gruri është një ndër kulturat që mbillet masivisht në fushën e Maliqit. Për të pasur rendiment të lartë prodhimi, Drejtoria e Bujqësisë në këtë bashki ka një bashkëpunim me QTTB Lushnjë për shkëmbim eksperience e për të përzgjedhur farat e grurit që i përshtaten zonës dhe japin cilësi e prodhim të bollshëm.

“Kemi bashkëpunim me QTTB Lushnjës, detyra jonë është që kultivimi i grurit të vihen në prova eksperimentale për të gjetur hibridet më të mirë dhe për tua rekomanduar fermerëve”, u shpreh Arben Dulellari, Drejtor i Bujqësisë dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Bashkia Maliq.

Ndryshimet klimatike të viteve të fundit kanë bërë që vera të jetë më e nxehtë e për të

shmangur problematika në këtë kulturë këshillohet përzgjedhja

jetë në standardin e kërkuar në treg. Në Maliq kjo kulturë mbil-



prodhim të bollshëm. Kemi një bashkëpunim të mirë dhe me

e kultivarëve me pjekje më të hershme në mënyrë që të mos ndikohen nga temperaturat e larta të verës dhe prodhimi të

let masivisht, ndërsa fshatrat ku prodhohet sasia më e madhe janë Pojani, Pirgu, Zvirina, Sheqerasi, etj.

Skema e subvencioneve në bujqësi, në Gjirokastrë aplikime të shumta për naftën

Në qarkun e Gjirokastrës, fermerët po vazhdojnë me ritme të larta aplikimet për të përfituar nga skemat kombëtare

që lidhen me sektorin e blegtorisë dhe mbështetjen me naftë për punimet e mekanizuara në bujqësi.

të kaluar kanë qenë 1440 aplikantë. Deri në fund të periudhës mendohet që kjo shifër do të arrihet. Ndërsa për skemat e tjera, për të imëtat, aplikantët pothuajse i kanë mbyllur aplikimet. Jemi thuajse në ato shifra si në vitin e kaluar”, tha Balil Bineri Specialist i Bujqësisë.

Kosta Dinaj blegtor nga fshati Shëntodhëri i Gjirokastrës prej disa vitesh ka përfituar nga skemat mbështetëse. Për të kjo është një ndihme ekonomike për të përballuar vështirësitë.

“Për bagëtitë kemi aplikuar çdo vit. Blejmë tokat që kullosim. Kanë shumë shpenzime. Kemi vite që marrim”, u shpreh Kosta Dinaj, blegtor.

Aplikimet për Skemat Kombëtare në Bujqësi do të jenë të hapura deri në datë 30 maj 2025.



punimet e mekanizuara në bujqësi. Tek skema e naftës deri tani

të mbështetjes në bujqësi. Interesi këtë vit është veçanërisht i madh, sidomos për subvencionet

“Tek skema e naftës deri tani kanë aplikuar 1030 fermerë. Nëse i referohemi kuotës së vitit

Bashkëpunim me Izraelin për modernizimin e bujqësisë dhe zhvillimin e agrobiznesit

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Anila Denaj, priti në një takim ambasadorin e Izraelit, Gali Peleg, dhe drejtorin e Qendrës së Trajnimit Bujqësor në MASHAV, Giora Tesler.

Gjatë këtij takimi, ata diskutuan për thellimin e bashkëpunimit në sektorin e bujqësisë, me fokus në mbështetje teknike dhe transferimin e njohurive.

Ministria Denaj theksoi rëndësinë e modernizimit të sektorit të bujqësisë dhe zhvillimit të agrobiznesit si një fushë me potencial të lartë ekonomik. Ajo veçoi gjithashtu mundësitë që ofron klima shqiptare për kultivimin gjithëvjeter.

“Në këtë frymë, ramë dakord për rëndësinë e një bashkëpunimi të strukturuar dhe të

fokusuar në rezultate konkrete, me synimin për të ndërtuar një

Ky takim është një hap i rëndësishëm në forcimin e



sektor bujqësor konkurrues, që do të nxisë zhvillimin rural të qëndrueshëm”, deklaroi ministria Denaj.

marrëdhënieve dypalëshe dhe promovimin e një zhvillimi të qëndrueshëm në sektorin e bujqësisë në Shqipëri.

Gjolla për ATSH-në: Naftë pa taksa për fermerët, mbi 19 000 aplikime në qarkun e Korçës

Fermerët e qarkut të Korçës po vazhdojnë me ritme të larta aplikimet për të përfutur nga skemat kombëtare të mbështetjes në bujqësi, ndërsa aplikimet mbyllen në datën 30 maj 2025.

Drejtori i Agjencisë Rajonale e Ekstensionit Bujqësor, Vullnet Gjolla, bëri të ditur për ATSH-në se, këtë vit fermerët po tregojnë interes të veçantë për subvencion në mbështetjen me naftë për punimet e mekanizuara në bujqësi dhe për sektorin e blegtorisë.

“Deri tani në Qarkun e Korçës kanë aplikuar 19 300 fermerë. Deri në fund të peri-

udhës mendohet që kjo shifër do të arrijë në mbi 20 mijë. Ndërsa vijojnë aplikimet edhe për skemat e tjera: për të imtat, bimët mjekësore, prodhim organik, ku paraprakisht jemi në shifrat si në vitin e kaluar”, u shpreh Gjolla.

Sipas Gjollës, këtë vit numri i fermerëve aplikantë, krahasuar me një vit më parë është në rritje të konsiderueshme dhe numri i përfutuesve parashikohet të jetë i lartë.

Fermerët në të gjithë vendin, prej disa vitesh po përfitojnë financim nga skemat mbështetëse. Për ta kjo është një ndihmë ekonomike në

rritjen e biznesit të tyre.

Skemat e Mbështetjes ofron 8 masa mbështetëse dhe afati për kryerjen e aplikimeve mbyllet më 30 maj.

Skema Kombëtare shkon aktualisht për prodhim dhe kjo skemë ndihmon kostot e drejtpërdrejta të fermerëve për të mundësuar të ardhura ekonomike.

Aplikuesit në grupimet e Bashkimit të Fermerëve do të përfitojnë të parët dhe secili prej tyre do të marrë në llogari të veçantë masën e financimit në nivelin maksimal, duke synuar realizimin e të njëjtit produkt bujqësor, drejt të njëjtit treg dhe të njëjtit protokoll prodhimi.

Gonxhja: Studim për zonën e ish-Kombinatit, synohet kthimi në qendër ekonomike

Ministri i Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Blendi Gonxhja tha se në ish-Kombinat në Tiranë do të ketë shumë

me urgjencë për t’u kthyer në qendra që të mund të përfshihen në ekonomi dhe industri rekreative apo në ekonominë e

edhe për detyrimet që kemi për dekarbonizimin dhe ekonominë e gjelbër dhe për shërimin mjedisor të disa prej zonave si Kombinati që e vuajnë të shkuarën e këtyre industrive, të cilat nuk mund të mbeten sot mes qendrave urbane në gjendjen që janë.

“Ky projekt do të ndihmojë shumë për konceptimin e planeve, për shembull parkun e Metalurgjikut për zonën industriale, ku do të punojnë atje me zhvilluesit që aktualisht janë më të gjithë zhvilluesit si dhe për parqe të tjera ekzistuese me zhvillues publik e privat siç është edhe parku Xhafzotaj, si parku TEDA Tiranë me zhvillues bashkinë e Tiranës, që të gjitha parametrat dhe standardet e këtyre parqeve ekologjike të jenë sa më eko”, tha Gonxhja.

Gonxhja tha se “vetëm vitin e kaluar janë licencuar dy parqe me zhvillues publikë. Në radhë të parë duhet që këto parqe të popullohen me biznese, kanë filluar të nënshkruhen kontratat, të fillojë punësimi, të ndizen makineritë dhe të ketë vende punë cilësore, me paga shumë të larta”.



shpejt një studim për të parë mundësinë se si mund të shërohet kjo zonë nga degradimi”.

Në një prononcim për mediet, pas nënshkrimit të marrëveshjes së bashkëpunimit me IFC që mbështet zhvillimin e Parqeve Eko-Industriale në Shqipëri, Gonxhja tha se “zonat si ajo e ish-kombinatit dhe e ish-njësive të prodhimit janë sot në gjendje shpesh të braktisur dhe të degraduar. Këto zona duhet të shikohen

gjelbër”.

“Shumë shpejt do të ndërhyrë për të zhvilluar zonat që duhet të përfshijnë gjithçka nga rekreacioni, tek zonat sociale, sportive, ekonomike, tregje të cilat do të ofronin mundësi për të rinjtë, për moshat e ndryshme dhe për të gjeneruar ekonomi, jetë sociale, kulturë, art”, tha Gonxhja.

Ne, tha Gonxhja, kemi një rol kryesor për të luajtur jo vetëm për ekonominë, por

Vjelja e qershisë në Godolesh, fermerët të kënaqur me kërkesën e lartë të konsumatorit vendas

Në fshatin Godolesh të Bashkisë Elbasan ka nisur vjelja e qershisë, një pemë karakteristike e zonës e kultivuar prej dekadash në kodrat e fshatit. Fermerët janë të kënaqur me ecurinë e tregut, pasi një kilogram qershí shitet me 400-450 lekë, varësisht nga cilësia

Ky çmim është arritur për shkak të shfaqjes së qershivë të para, të cilat kanë cilësi elitare. “Sivjet ka qenë më mirë,

krahasim me vitet e kaluara”, shprehen fermerët.

Fermerët shprehen se qershitë seleksionohen për të nxjerrë në treg më të mirën, duke mbajtur kërkesën të lartë. Edhe pse prodhimi këtë vit është më i ulët për shkak të kushteve të motit, cilësia nuk ka humbur.

“Prodhim më i pastër, tregumë i mirë. Jemi të kënaqur me mallin që del në treg dhe me çmimin”,

shprehen konsumatorët.

Vjelja e qershivë ka bashkuar të rinjtë dhe të moshuarit, pasi të rinjtë kthehen nga emigracioni për t’i ndihmuar prindërve, duke sjellë fitime të mëdha.

Godoleshi është tani një destinacion i frekuentuar nga tregtarët e Tiranës, Korçës, Durrësit dhe qytetarët e Elbasanit që duan t’i marrin qershitë drejtpërdrejt nga pema.

Përfaqësuesi i FAO-s për Shqipërinë, Jehle: Mbështetje në hartimin e politikave bujqësore në kontekstin e anëtarësimit në BE

Raimund Jehle, përfaqësues i FAO-s në Shqipëri dhe Drejtues i Programit Rajonal për Evropën dhe Azinë Qendrore, e cilësoi “bujqësinë në Shqipëri, një sektor të rëndësishëm në zhvillim, që angazhon 36% të popullsisë në punë dhe siguron të ardhura të konsiderueshme në ekonominë e vendit”.

Në një intervistë për RTSH-

embull i mirë në këtë drejtim, është puna që po bën FAO me një inkubator për gratë rurale në Elbasan dhe mbrojtja biologjike e pyjeve të gështenjës.

“Ne po u ofrojmë atyre teknologji dhe njohuri, në mënyrë që këto gra fermere të jenë në gjendje të përpunojnë dhe të shesin perime, duke i çuar ato në treg. Kjo u siguron atyre të

në mënyrë më efektive.

“Bujqësia Digjitale dhe Transformimi Rural në Shqipëri, i cili aktualisht po zbatohet nga Zyra e FAO-s në Shqipëri, ka një rol të rëndësishëm në këtë drejtim. Nga njëra anë, ai ndihmon përmes Portalit të Fermerëve, duke u ofruar fermerëve qasje ndaj informacioneve mbi tregun dhe të dhëna të tjera rëndësishme. Nga ana tjetër, projekti kontribuon edhe në rritjen e përdorimit të të dhënave, siç janë imazhet satelitore, informacionet për kontrollin fitosanitar dhe shërbimet këshillimore të gjitha këto mjete ndihmojnë në transferimin e dijeve dhe njohurive në mënyrë të drejtpërdrejtë te fermerët”, theksoi Jehle.

Ai u shpreh se, procesi i anëtarësimit në Bashkimin Evropian është faktori kryesor nxitës i zhvillimit në Shqipëri.

Jehle nënvizoi se, bujqësia luan një rol të rëndësishëm në prodhimin bujqësor, sigurinë ushqimore dhe përpunimin.

“Përtej përkthimit të legjislationit, FAO po mbështet institucionet e linjës në ngritjen e sistemeve të duhura që nevojiten për të hartuar politikë përkatëse në kontekstin e anëtarësimit në BE”, theksoi Jehle.

Ai shprehu besim për progresin e bujqësisë në Shqipëri.

“Ekziston një potencial real për investime në bujqësi, por edhe në agroturizëm, përmes lidhjes së prodhimit bujqësor me turizmin. Një fushë që nuk është diskutuar sa duhet, por që meriton më shumë vëmendje, është akuakultura dhe sektori i peshkimit. Shqipëria ka një vijë të gjatë bregdetare, dhe akuakultura dhe peshkimi janë pjesë e sistemit agroushqimor. Kjo ofron një mundësi unike për të kombinuar prodhimin ushqimor me turizmin dhe për të tërhequr investime në një peizazh dhe mjedis të mrekullueshëm”, deklaroi Jehle.



në Jehle tha se, “në Shqipëri bujqësia nuk duhet të shihet thjesht si një proces prodhimi, por si një sektor me ndikim të gjerë në krijimin e të ardhurave”.

Po ashtu, vijoi ai, bujqësia duhet të lidhet ngushtë edhe me çështjet mjedisore e sociale, duke ndikuar në mënyrën se si njerëzit jetojnë dhe bashkëjetojnë në zonat rurale.

Jehle foli për zhvillimin e qëndrueshëm të këtij sektori dhe mbështetjen që adreson FAO për fermerët shqiptarë.

“Synimi ynë është të prodhojmë ushqim duke përdorur burimet ujore në mënyrë sa më efektive. Shqipëria ka burime të shumta ujore, por duhet të kemi parasysh se, për shkak të ndryshimeve klimatike, situata po ndryshon gradualisht. Prandaj, kemi nevojë për një metodologji prodhimi që i përgjigjet të gjitha këtyre sfidave. Kjo është pikërisht ajo që nënkuptojmë kur flasim për prodhim bujqësor të qëndrueshëm”, theksoi ai.

Jehle shpjegoi se, një sh-

ardhura dhe, në këtë këndvështrim, ne po zhvillojmë të gjithë zinxhirin e vlerës. Gjithashtu një tjetër shembull është edhe një projekt nëpërmjet të cilit po punohet për mbrojtjen biologjike të pyjeve të gështenjës, me synimin për të mbështetur sigurimin e të ardhurave, për të ndihmuar komunitetet e zonave rurale dhe nxitur zhvillimin rural”, tha Jehle.

Ai vlerësoi biodiversitetin e pasur, klimën e përshtatshme për kultivimin e një game të gjerë ushqimesh dhe pozicionin gjeografik, me potencial të madh turistik, si tri fushat që e bëjnë unike Shqipërinë në sektorin e bujqësisë dhe zhvillimit rural.

Sipas tij, zhvillimi i sistemeve agroushqimore do të thotë qëndrueshmëri ekonomike, mjedisore dhe sociale.

Duke folur për digjitalizimin e bujqësisë, Jehle u shpreh se, kjo ka të bëjë me përdorimin e teknologjive moderne, satelitore, për të prodhuar ushqim dhe për të shfrytëzuar burimet

Pjeshkët e Lushnjes pa cilësi, shiten me çmim të lirë! Fermerët: Këtë vit s'presim fitime, na dëmtoi breshëri

Në Fiershegan të Lushnjes, aty ku fermerët kanë kultivuar 200 hektarë me pjeshka prodhimi është dëmтуar për shkak të breshërit. Për pasojë prodhimi nuk shkon për eksport por shitet në tregun vendas nën kosto. Fermerët ankohen se kanë humbje të mëdha financiare

Fiershegani në Lushnje është zona më e madhe në vend e prodhimit të pjeshkave e nektarinave me një sipërfaqe mbi 200 hektarë. Kanë mjaftuar 15 minuta breshër, një muaj më parë për të çuar drejt falimentit fermerët. Tashmë që është koha e vjeljes, vihet re rënia e prodhimit me rreth 50- 60% krahasuar me vitin e kaluar.

Destinacioni kryesor vitet e mëparshme ka qenë eksporti në vendet e Rajonit dhe Europës, ku një kg nektarinë tregtohej

me 200 lekë. Ndërsa këtë vit për shkak të rënies së cilësisë gjithë prodhimi shkon në tregun vendas me çmim mesatar 50- 60 lekë/kg. Gjasat janë që çmimi të pësojë sërish rënie për shkak të cilësisë jo të mirë.

“Jemi shumë të dëmтуar nga breshëri, kërkojmë subveccion nga shteti.

Rendimenti këtë vit është shumë i ulët, jemi në vështirësi.

Gjysmën e prodhimit e kam hedhur në tokë, gjysma që ka mbetur shitet në tregun e

brendshëm me çmim të ulët.

Kemi falimentuar këtë vit, nuk mbulojmë as shpenzimet”, - thanë fermerët, Agim Kamxhiu, Daniel Tushe dhe Baki Myqezari.

Prodhimi nuk është i siguruar dhe fermerët e Fiersheganit shprehen jashtë kamerës se nuk mund ta sigurojnë nga fatkeqësitë natyrore pasi asnjë kompani sigurimesh nuk e ofron policën e sigurimit për shkak të koston së lartë.

Balla: “Paketa e Maleve”, zhvillim agroturizmi në tokat e të parëve

Vila “Si Era” përgjatë rrugës së lumit të Vlorës, vetëm 30 minuta nga Vlora ose nga Himara, përballë urës historike në Brataj, ka hapur dyert për turistët.

Ministri i Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin dhe njëherësh Drejtuesi Politik i Partisë Socialiste për Diasporën, Taulant Balla ndau sot në rrjetet sociale pamje nga ky investim, teksa theksoi se, “Paketa e Maleve” është mundësia për të rigjallëruar tokat e të parëve.

“Siç u zotua para diasporës “Paketa e Maleve” është mundësia për të rigjallëruar tokat e të parëve, për të ndërtuar bujtina e agroturizëm dhe për të sjellë krenari e zhvillim në vendin tonë, kudo”, theksoi Balla.

Balla shtoi se, “Paketa e Maleve sjell “lehtësi në proceset e legalizimit dhe certifikimit të pronave të trashëguara nga prindërit dhe gjyshërit tuaj”.

“Paketa e Maleve”, i hap rrugë investimeve në agroturizëm, agropërpunim dhe turizëm malor, duke u dhënë një mundësi reale dhe mbështetje të posaçme të gjithë atyre që

duan të rikthehen në tokat e të parëve nga qyteti apo nga jashtë vendit, për të arritur një sukses ekonomik për familjen e tyre, me procedura krejt të thjeshtuara dhe lehtësira fiskale, deri edhe 10 vjet Zero Taksa e Zero TVSH për 500



aplikantët e parë.

“Paketa e maleve”, miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë synon të zgjidhi një seri problemesh që kanë të bëjnë me mundësinë për të zhvilluar dhe për të investuar në zonat malore dhe

ato që do të shpallen me interes për zhvillim.

Sipas ligjit, çdo bashki që ka një zonë malore ka të drejtë të shpalli një zonë malore prioritare për tu zhvilluar dhe është Këshilli i Ministrave ai që i jep kësaj zone statusin për tu zhvilluar.

Personat që janë pronarë të tokës në këtë zonë dhe nuk disponojnë certifikatë pronësie, por duan të ndërmarrin investime për zhvillimin turistik të saj, do të mbështeten përmes kësaj pakete në sipërmarrjen e tyre.

Marrëveshja e pensioneve me Italinë, Manjani: Nuk humbet asnjë ditë pune

Nga 1 qershori do të nisë njohja e pensioneve me Italinë pas marrëveshjes së arritur mes dy vendeve.

Olta Manjani, zëvendësministria e Ekonomisë, në një intervistë në një media e cilësoi arritjen e kësaj marrëveshje historike.

“Është një marrëveshje historike për shumë arsye. Arsyeja e parë është për shkak të numrit

Manjani tha se përfitojnë mbi 500 mijë shqiptarë që kanë kontribuar në Itali dhe 4 mijë italianë që jetojnë në Shqipëri.

“Kemi përlogaritur që do të jenë mbi 500 mijë shqiptarë, që do të përfitojnë nga kjo marrëveshje. Ndërkohë në Shqipëri janë rreth 4 mijë italianë, të cilët jetojnë dhe punojnë në vendin tonë. Është një numër i kon-

përfutur një pension në Shqipëri është 15 vite, ndërkohë që në Itali është 20 vite. Dhe, të gjithë ata shtetas që nuk e plotësojnë numrin minimal të viteve për përfitimin e një pensioni do të kenë një bashkim të periudhave kontributive. Pra, nëse do të kenë 10 vite këtej dhe 12 vite andej, në total do të kenë një pension ekuivalent me 22 vite, ku në shtetin përkatës do të përfitojnë pensionin që është ekuivalent me masën e kontributit. Nga ana tjetër, do të përfitojnë edhe shqiptarë që mund të jenë duke kontribuar në skemën italiane të pensioneve. Pra, nuk e kanë prekur ende skemën shqiptare, por nëse vendosin të kthehen dhe të kontribuojnë në skemën shqiptare të pensioneve, sigurisht që nuk do të humbasin asnjë ditë kontribute në skemën italiane”, tha Olta Manjani.

Në marrëveshje parashikohet që përfitimet janë të barabarta mes shqiptarëve që kanë punuar dhe jetuar në Itali dhe italianëve që jetojnë në Shqipëri.

Sa i takon marrëveshjes me Greqinë, Manjani informoi se marrëveshja është gati dhe janë bërë dy takime teknike, ku ka rezultuar që ka një përputhshmëri mes sistemit tonë dhe atij grek.

“Rezulton që sistemi ynë edhe me shtetin grek është shumë i përputhshëm dhe presim një vullnet politik nga ana e shtetit grek për të vijuar më tej me negociatat teknike zyrtarisht”, theksoi ajo.

siderueshëm, veçanërisht për shkak të mbulimit me elementë të sigurimeve shoqërore, të një numri kaq të madh, i shtetasve shqiptarë që punojnë dhe jetojnë në Itali. Është një marrëveshje shumë e mirë, e cila siguron disa përfitime. Siguron përfitime në terma të totalizimit dhe bashkimit të periudhave kontributive. Pra, për të gjithë shqiptarët që kanë punuar këtej dhe matanë kufirit nuk do të humbasin asnjë ditë pune nga kontributet e tyre”.

“Numri minimal për të



të lartë të shqiptarëve, të cilët prej vitesh jetojnë dhe punojnë në shtetin fqinj. Por, njëkohësisht edhe për shkak të zgjatjes së arritjes së një marrëveshjeje të tillë, e cila ka filluar teknikisht dhe zyrtarisht në vitin 2022. Gjatë gjithë kësaj periudhë kemi konkluduar në një marrëveshje të mirë, e cila përfshin shumë përfitime për të gjithë shtetasit shqiptarë që janë në Itali, si edhe për shtetasit italianë, të cilët vitet e fundit kanë ardhur në rritje në numër”, tha Manjani.

Sipas përlogaritjeve të bëra,

Dekarbonizimi i sektorit të energjisë - Komuniteti i Energjisë: Miratimi dhe zbatimi i legjislacionit, i përmbushur në masën 66%

Miratimi dhe zbatimi i legjislacionit të nevojshëm për dekarbonizimin e sektorit të energjisë nga Shqipëria është përmbushur në masën 66%. Raporti i fundit i Komuniteti të Energjisë jep të dhëna mbi ecurinë e disa treguesve,

gazeve serrë, përmbushja rezultoi në masën 80%. Sipas raportit Shqipëria nuk ka përcaktuar një objektiv klimatik për vitin 2030 në legjislacionin kombëtar, por ai është përfshirë në strategjinë kombëtare. Ndaj, ven-



sipas angazhimeve të ndërmarra nga vendi ynë. Kështu, sa i takon Planit Kombëtar për Energjinë dhe Klimën, angazhimi është përmbushur në masën 62%, pasi dokumenti u miratua në dhjetor 2021, ndërkohë që puna për përditësimin e planit vazhdoi në vitin 2024, por nuk është finalizuar. “Shqipëria duhet të përfundojë pa vonesë procesin e përditësimit”, -vlerëson raporti.

Sa i takon targeteve të vendosur për reduktimin e

di duhet të marrë në konsideratë ndryshimin e ligjit “Për ndryshimet klimatike”, për ta përafëruar me objektivin e vitit 2030 të vendosur nga Komuniteti i Energjisë.

Ndërkaq, në drejtim të sistemeve kombëtare të raportimit klimatik përmbushja raportohet në masën 92%, pasi ekziston një bazë ligjore për një sistem kombëtar të inventarit të gazeve serrë. Megjithatë, Shqipëria duhet të zbatojë më tej një sistem kombëtar për vlerësimin e

emetimeve të këtyre gazeve, që përfshin mbledhjen e të dhënave të emetimeve për të gjitha kategoritë e Panelit Ndërqeveritar për Ndryshimet Klimatike, vendosjen dhe zbatimin e masave të kontrollit të cilësisë, si dhe vlerësimet e pasigurisë në nivel kombëtar.

Ndërkaq, për politikat dhe masat kombëtare për gazet me efekt serrë përmbushja raportohet në masën 71%. “Detyrimet e raportimit janë transpozuar në legjislacion. Raportimi është finalizuar për politikat dhe masat, si dhe për të ardhurat nga mekanizmat e çmimit të karbonit. Megjithatë, raporti mbi strategjitë e përshtatjes ende duhet të dorëzohet në sistemin Reportnet”, - thuhet në dokument.

Më dobët, vendi ynë paraqitet në drejtim të strategjisë afatgjatë dhe neutralitetit klimatik, që vlerësohet i përmbushur në masën 25%. “Është miratuar baza ligjore për një strategji afatgjatë. Megjithatë, Shqipëria nuk ka miratuar ende një strategji afatgjatë me objektivin e neutralitetit klimatik për vitin 2050. Mbetet e paqartë nëse dhe si do të arrihet një objektiv i tillë”, - thuhet në raportin e Komuniteti të Energjisë.

AKU: Sasia e filetove të derri e kontaminuar me salmonelë u asgjësua sipas protokolleve të sigurisë



Autoriteti Kombëtar i Ushqimit bëri të ditur se sasia prej 4516, 75 kg fileto mish derri i importuar nga Brazili, që rezultoi i kontaminuar me salmonella spp, është asgjësuar në respektim të plotë të të gjitha protokolleve të sigurisë ushqimore.

Në një njoftim për mediet, AKU shpreh shqetësimin

për përhapjen e lajmeve të pavërteta të publikuara në disa media dhe portale në lidhje me sigurinë ushqimore.

AKU sqaron se, “sasia prej 4516, 75 kg fileto mish derri e importuar nga Brazili, është bllokuar nga ky autoritet më datë 28.1.2025, pas raport analizave të kryera, ku ka

rezultuar i kontaminuar me salmonella spp. Kjo sasia mishi ka qëndruar e bllokuar në magazinat e subjektit importues, deri më datë 16.4.2025, kohë kur subjekti importues u ka bërë kërkesë për asgjësim, autoriteteve kompetente si: Inspektoriati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit (Drejtorja e Inspektimit të Mjedisit të Ujërave), Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Tiranë dhe Drejtorisë Rajonale AKU Tiranë”.

AKU siguron konsumatorët se e gjithë sasia prej 4516, 75 kg fileto mish derri është asgjësuar në prani të të gjithë përfaqësuesve të autoriteteve kompetente.

“Autoriteti Kombëtar i Ushqimit është në gatishmëri të plotë për garantimin e sigurisë ushqimore, në mbrojtje të shëndetit të konsumatorit”, thuhet në njoftimin e AKU-së.






→ Kibucosa pake protabile ut
năsturești în specializarea a
agricultorilor.

→ Agricultorii pot beneficia din
această industrie.

→ Alături dea țării, țării
năsturești, agricultorii ai
țării.

→ Alții a țării ai producției
năsturești ai țării.

→ (Pentru țării) în țării
năsturești năsturești ai țării
năsturești ai țării.



→ Kibucosa a țării ai țării
năsturești ai țării.

→ Kibucosa a țării ai țării
năsturești ai țării.

→ Kibucosa a țării ai țării
năsturești ai țării.

→ Kibucosa a țării ai țării
năsturești ai țării.



→ Kibucosa a țării ai țării
năsturești ai țării.

→ Kibucosa a țării ai țării
năsturești ai țării.

→ Kibucosa a țării ai țării
năsturești ai țării.

→ Kibucosa a țării ai țării
năsturești ai țării.

4. *Integritate* / specie de păsăritărie: vînd de habitant la care din păsărilor / numele și rețea kinematică de controlat funcționează.

© 2010 Blackwell Publishing Ltd *Journal of Internal Medicine* 267: 101–108

[illegible]

Ingrediente speciale în compoziția sa, de aceea este în compoziția, este din nou pe
 hidroxime și hidroxime SAR. În vârstă, înțelesul lui este foarte mare în termenii
 modului în care este înțeles în hidroxime, deoarece este în termenii hidroxime și
 produsul este în termenii hidroxime și hidroxime.

gives a low-molecular-weight, soluble polymer, which is insoluble in water, but soluble in organic solvents. The polymer is soluble in water, but insoluble in organic solvents. The polymer is soluble in water, but insoluble in organic solvents.



KREDI E SHPEJTË MIKRO

PËR ÇDO QËLLIM BIZNES APO INDIVID

KREDI MIKRO

deri në **2,500,000** LEKË



INFORMACIONE

Diskutime mbi zbatimin për Shqipërinë të marrëveshjeve për lëvizjen e lirë brenda rajonit

Lëvizja e lirë e qytetarëve në rajon është një nga shtyllat kryesore të Bashkimit Evropian dhe një nga përfitimet më konkrete që qytetarët e Ballkanit Perëndimor presin nga procesi i integritimit. Për të përshpejtuar këtë proces,

bilitetin e njerëzve.

Diskutimet u përqendruan në tetë marrëveshje dhe një rekomandim të dakordësuar nga vendet anëtare të CEFTA-s në tetor 2024. Deri më tani, vetëm tre prej tyre janë ratifikuar nga të gjitha vendet

kapaciteteve teknike të mjaftueshme për zbatim të qëndrueshëm.

Olivera Ceni-Bardiqi nga CEFTA, prezantoi një analizë të detajuar mbi situatën e ratifikimit të 11 marrëveshjeve të nënshkruara në Berlin në 2024 dhe në Prishtinë në 2025. Znj. Ceni-Bardiqi nënvizoi progresin a pabarabartë të harmonizimit ndërmjet vendeve si një nga sfidat aktuale.

Nga ana e saj, Alketa Vejseli nga Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit (MEKI), nënvizoi volumin e rëndësishëm të punës për CEFTA dhe CRM, dhe nevojën për forcim të kapaciteteve në administratën publike, në një moment ku Shqipëria është e angazhuar për përmbylljen e negociatave me BE-në deri në vitin 2027.

Përfaqësues të GIZ Shqipëri ndanë përvojën në mbështetjen për institucionet shqiptare për përafrimin e legjislacionit me standardet e BE-së në fushën e lëvizjes së lirë të mallrave dhe shërbimeve. Projekti SAN-ECA solli shembuj praktikë nga puna a bërë në kuadër të njohjes nga BE të kualifikimeve dhe diplomave të lëshuara nga institucionet shqiptare, dhe ndërsjelltas.

Tryeza e rrumbullakët u mbyll me fjalën e Mia Marzouk, Zëvendës Ambasadore e Britanisë së Madhe në Shqipëri, e cila u shpreh se diskutimet e sotme do të kenë vendin e tyre në përgatitjen e Samitit të radhës të Procesit të Berlinit që do të mbahet në Mbretërinë e Bashkuar në muajin tetor.

Seria rajonale e aktivitetëve do të kontribuojë në pasurimin e debatit mbi integrimin e rajonit në tregun unik evropian dhe do të kulmojë në edicionin e 11-të të Tirana Connectivity Forum, që do të zhvillohet më 16-17 shtator 2025.

Mungesa e qershisë në treg, temperaturat e ulëta frenojnë prodhimin vendas

Ndryshe nga vitet e kaluara, ku prodhimi i qershisë ishte i bollshëm, këtë vit ka një mungesë të theksuar. Si pasojë, edhe çmimi ka shënuar rritje të ndjeshme, duke arritur deri në 600 lekë për kilogram.

Ardit Keçi, tregtar në tregun agro-ushqimor, tregon se ky vit ka qenë i dobët për sa i përket prodhimit të qershisë.

“Kur qershia ishte në lulëzim temperaturat ishin të ulëta dhe për këtë arsye kemi mungesë të saj”, u shpreh fermeri Ardit Keçi.

Në vitet e kaluara kishte prodhim të bollshëm, dhe çmimi ishte rreth 200-300 lekë për kilogram, më i pranueshëm për konsumatorët.

“Vitet e tjera ka pasur qershi më bollëk dhe çmimi ka

tregut vërehen kryesisht prodhime vendore, sidomos per-



i përket prodhimit të qershisë. Ka mungesa sepse

qenë shumë i arsyeshëm”, u shpreh fermeri.

Aktualisht, në tezgat e

ime të ndryshme që janë në sezon dhe me furnizim më të qëndrueshëm.

Sfidat dhe zhvillimet në fushën e sigurisë dhe drejtësisë, një delegacion francez inspekton pikën kufitare e doganore të Qafë Thanës

Një delegacion prej 80 zyrtarësh të lartë nga Instituti për Studime të Larta i Ministrisë së Brendshme franceze (IHEMI) po zhvillon një vizitë studimore në Shqipëri, me qëllim njohjen nga afër me sfidat dhe zhvillimet në fushën e sigurisë dhe drejtësisë në vendin tonë.

Në kuadër të programit të vizitës, delegacioni francez zhvilloi një inspektim në pikën e kalimit kufitar të Qafë Thanës, ku u njoh nga afër me strukturat dhe funksionimin e Policisë së Shtetit dhe të Doganave shqiptare në këtë zonë strategjike të kufirit me Maqedoninë e Veriut.

“Gjatë vizitës në terren, zyrtarëve francezë iu prezantua organizimi i punës në këtë pikë doganore, masat për menaxhimin e fluksit të udhëtarëve dhe mallrave, si dhe teknologjitë e përdorura për

garantimin e sigurisë kufitare”, bën të ditur Drejtoria e Përgjithshme e Doganave (DPD).

Një demonstrim praktik i funksionimit të skanerit në

dhe krimeve ndërkufitare.

Sipas DPD, vizita është hap konkret në thellimin e bashkëpunimit mes institucioneve shqiptare dhe atyre franceze



procesin e kontrollit të automjeteve u zhvillua si pjesë e vizitës, duke ilustruar masat moderne të kontrollit dhe parandalimit të kontrabandës

në drejtim të forcimit të kapaciteteve në fushën e sigurisë, menaxhimit të kufijve dhe zbatimit të ligjit, në përputhje me standardet evropiane.

Grantet për artizanatin dhe konkurrueshmërinë, AIDA shpall 86 fitues

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA) njoftoi se kishte shpallur 86 ndërmarrje të mikro, të vogla dhe të mesme si fituese të granteve që synojnë rritjen e konkurrueshmërisë

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA) njoftoi se kishte shpallur 86 ndërmarrje të mikro, të vogla dhe të mesme si fituese të granteve që synojnë rritjen e konkurrueshmërisë.

Në një listë të bërë publikë të paktën 10 pre tyre i takojnë granteve të dedikuara për artizanatin, 19 ndërmarrje që duan fokus tek konkurrueshmëria dhe 57 ndërmarrje që do të përfitojnë grante për shpenzime korrente.

“Në vijim të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 26, datë 10.01.2025, për mbështetjen e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme (NMVM), të cilat synojnë rritjen e konkurrueshmërisë së tyre, zhvillimin e produkteve dhe shërbimeve, inovacionin dhe rinovimin e teknologjisë, zhvillimin e artizanatit si dhe

mbështetjen e grave sipërmarrëse me qëllim nxitjen drejt eksportit dhe forcimin e aftësive të NMVM-ve lidhur me shërbimet dhe produktet për një treg të qëndrueshëm, AIDA, shpalli dhe administroi thirrjen për grante për vitin 2025 gjatë periudhës 30 janar-28 shkurt 2025. Gjatë kësaj periudhe në adresën e AIDA-s, mbërritën 443 kërkesa për mbështetje financiare”, njoftoi Agjencia të enjten e kësaj jave.

Në lidhje me mbështetjen me grante AIDA aplikon dy skema ku e para mbështetje financiare për shpenzime korrente me vlerë financimi deri në 2.5 milionë lekë dhe mbulim të kostove në 100 për qind. Në kostot e mbulueshme hyjnë disa prej tyre duke nisur nga certifikimi i standardeve deri tek materialet promovuese.

Në skemën e dytë është ajo mbështetje për shpenzimet kapitale ku bëjnë pjesë projektet e konkurrueshmërisë me vlerë financimi deri në 1.5 milionë lekë dhe mbulim kostosh 100 për qind si dhe projekte artizanati me vlerë financimi deri në 1 milionë lekë dhe mbulim të kostove 100 për qind.

Në rastin e parë për projektet e konkurrueshmërisë kostot e mbulueshme përfshijnë blerje të makinerive që ndikojnë në rritjen e prodhimit dhe përmirësimin e cilësisë së produktit kurse sa i takon artizanatit blerje të makinerive tradicionale dhe/ose teknologjike për të përmirësuar kushtet e punës për biznesin si dhe blerje e aplikacioneve dhe/ose programeve të e-commerce.

“Monitor”



TURIZËM

Ndërsa shumë turistë zgjedhin të vijnë në Shqipëri për të zbuluar bukurinë e plazheve mesdhetare pa turma vizitorësh, ju gjithashtu mund të përjetoni një qëndrim vërtet magjepsës në qytetin e lashtë të Gjirokastrës, shkruan Mina Elwell në revistën amerikane të udhëtimeve “Islands”.

Besohet se njerëzit kanë banuar në këtë qytet që nga viti 2000 p.e.s.

Ndërsa jeni duke ecur nëpër qytet – do të keni ndjesinë e kthimit pas në kohë, pasi të eksploroni muret e Kalasë së shekullit VI, xhaminë osmane – të ndërtuar në vitet 1400 – dhe Pazarin historik që daton pothuajse tre shekuj më parë.

Shqipëria është një nga destinacionet më të përballeshme në Evropë dhe Gjirokastra nuk bën përjashtim.

Mënyra më e lehtë dhe zakonisht më e lirë për të shkuar në Gjirokastrë me linjë ajrore – është të fluturonit për në Korfuz, të merrni një traget për në Shqipëri (zakonisht kushton rreth 35 dollarë) dhe pastaj të merrni autobusin nga Saranda në Gjirokastrë (rreth 5 dollarë).

Media amerikane “Islands”: Vizitoni “Qytetin e Gurtë” të Shqipërisë, i njohur për arkitekturën unike dhe kuzhinën e shijshme

Nëse po udhëtoni nga kryeqyteti, Tirana, do t’ju duhen rreth tre orë e gjysmë

Temperaturat mund të arrijnë mbi 37 gradë Celsius.

Rekomandohet të vizitohet



me makinë ose autobus për të arritur në Gjirokastrë.

Gjatë sezonit veror, Gjirokastra frekuentohet nga një numër i madh turistësh.

gjatë vjeshtës, për të shijuar atmosferën e qetë të “Qytetit të Gurtë”.

Turistët do të kenë mundësinë të marrin pjesë në Festivalin

Kombëtar të Folklorit – i cili mbahet çdo pesë vjet – pasi vera në Gjirokastrë ofron shumë muzikë, valle dhe ushqim.

Si është të vizitosh “Qytetin e Gurtë” të Gjirokastrës?

Lart në male, qyteti i Gjirokastrës është një vend unik, plot me arkitekturë osmane, rrugë me kalldrëm dhe një Kala madhështore – që pothuajse duket sikur është rritur natyrshëm nga shkëmbinjtë shkëmborë shqiptarë.

Harqet prej guri të Kalasë dhe pamjet e maleve ia vlejnë të vizitohen. Sapo të hyni brenda, do të shihni edhe dy muze historikë interesantë.

Vizita në Kalanë e Gjirokastrës kushton rreth 5 dollarë dhe rreth 3 dollarë shtesë për të parë muzetë.

Ju mund të mësoni gjithçka rreth historisë së qytetit dhe Kalasë – e cila shërbeu si një burg i tmerrshëm për të burgosurit politikë.

Gjithashtu, mund të vizitoni disa shtëpi të mrekullueshme prej guri.

Eksploroni “Shtëpinë e Zekatëve” të viteve 1800 për të zbuluar tavanet e saj të përpunuara, muret e pikturuara dhe dritaret mbresëlënëse prej qelqi me ngjyra. Mund ta vizitoni për më pak se 5 dollarë.

Mos humbisni një shëtitje në Urën e Ali Pashës. Dikur, kjo urë e lartë prej guri ishte pjesë e sistemit të ujësjellësit të qytetit, por sot është një shteg që vizitorët mund ta eksplorojnë.

Do t’ju duhet të ecni për rreth gjysmë ore për të arritur atje. Kjo është mënyra perfekte për të shijuar peizazhin përreth

qytetit.

Shijoni kuzhinën vendase të Gjirokastrës

Ekzistojnë shumë ushqime të shijshme për të provuar në Gjirokastrë, por mezja që nuk duhet të humbisni është Qifqi,

Qoftet me oriz kanë një aromë menteje dhe janë një specialitet i qytetit.

Gjithashtu, provoni byrekun e mbushur me mish dhe djathëra; mishin e pjekur në skarë dhe çajin e malit.

Për një vakt të paharueshëm në Gjirokastrë, shkoni në Pazarin e Vjetër, në qytetin e vjetër, ku do të gjeni shumë restorante dhe kafene.

Shumë hotele dhe bujtina me mëngjes në Gjirokastrë ofrojnë vakte të shijshme falas në mëngjes si pispili, reçel fiku dhe ëmbëlsira.

Shumë prej tyre janë të drejtuara nga familjarët, dhe aty mund të shijoni një vakt të gatuar në shtëpi, duke ju mundësuar një nga përvojat më autentike të kuzhinës mesdhetare gjatë udhëtimit tuaj.

Aplikacioni TEA, Kumbaro: Nga veriu në jug, aktivitetet turistike e kulturore nuk ndalen

Kalendari turistik i eventeve verore edhe këtë vit vjen i harmonizuar në aplikacionin TEA, Tourism Events of Albania.


Festivali i Monodramës nga 29 maj deri në 4 qershor në Tiranë; Aulona Inter Folk Festival nga 23-25 maj në Vlorë; Eja në Pre-

Maliq; Shkodra Art Residence në 25-31 maj, etj.

Aplikacioni TEA, i vetmi udhërrëfyes digjital i Shqipërisë turistike është një shembull i shkëlqyer sesi teknologjia mund të përdoret për të përmirësuar dhe modernizuar përvojën turistike, duke ofruar informacion të shpejtë, të saktë dhe të përshtatur për turistët.

Që nga lançimi i tij, ky aplikacion u ka mundësuar turistëve të kenë një përvojë më të pasur dhe të lehtë në eksplorimin e destinacioneve turistike të vendit.

Ky aplikacion është i disponueshëm falas në Apple Store dhe në Play Store dhe është projekt i Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit dhe i Agjencisë Kombëtare të Turizmit.



Ministrja e Turizmit dhe Mjedisit, Mirela Kumbaro ftoi të gjithë të instalojnë këtë aplikacion, për të mos humbur asnjë nga aktivitetet turistike që zhvillohen në vend.

“Nga veriu në jug, arti dhe aktivitetet turistike e kulturore nuk ndalen. Nga Tirana në Pre-spë, nga Shkodra në Gjirokastrë – festivale, ekspozita, teatër, muzikë harmonizohen në një kalendar plot jetë që sjell në skenë shpirtin krijues të artistëve shqiptarë dhe ndërkombëtarë”, tha Kumbaro.

Duke i bërë apel qytetarëve të instalojnë aplikacionin, Kumbaro u shpreh se “nëpërmjet TEA, udhërrëfyesit të aktiviteteve nëpër gjithë Shqipërinë përjetoni më të mirën e ngjarjeve kulturore dhe artistike”.

Ministrja Kumbaro ndau gjithashtu disa nga aktivitetet që do të zhvillohen gjatë muajit maj dhe qershor në të gjithë vendin si : “The Cloud Festival” nga 21-31 maj tek Reja në Tiranë; Edicioni i katërt i konkursit ndërkombëtar “Tempo” nga 22-25 maj;

spë 31 maj; Vjosa n’Fest në 23-24 maj; Vjosa Art në 21-31 maj; Qersh i mbi art dhe trashëgimi në

VJOSA

N'FEST

23-24 MAJ 2025

LISTA E AKTIVITETEVE

KONCERT MUZIKOR – SHESHI “MINATORI” (STAGE 1)

KONCERT MUZIKOR (STADIUMI)

MUZIKË ELEKTRONIKE (URA)

MBRËMJE POETIKE

HAPSIRA E FEMIJEVE

HIPIZËM

HIKING

EKSPOZITË PIKTURE

PAINTBALL

RAFTING

WORKSHOP BIZNESI

GUIDE KULTURORE

KINEMA

KONKURSI I FOTOGRAFIS

ME

TE

DOTS

RIO

Nis regjistrimi dhe hipotekimi i pronave, Malësia e Madhe i ndan sipas “kufijve të vjetër”

Bashkia Malësi e Madhe ka nisur procesin e regjistrimit fillëstar të pronave dhe hipotekimit të tyre. Për të sqaruar procedurat që duhen ndjekur, po zhvillohen takime në njësi të ndry-

projektit 1- vjeçar të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës.

“Malësia e Madhe ka pasur situatë problematike përse i përket regjistrimit fillestar të tokave. Janë 57 zona kadastrale,



shme administrative, ku përveç kryebashkiakut, Tonin Marinaj, është i pranishëm edhe Florian Shima, përfaqësues i kompanisë që do të implementojë

22 zona i gjetëm pa regjistrim fillestar ku 5 i regjistruam, ne si bashki. I financuam si projekt. 9 të tjera po i bën ASHK, pasi pa u bërë aty nuk mund të

kalosh as tek ligji 20/20. Janë dhe 6 zona që janë punuar nga ASHK dhe janë drejt përfundimit. Janë edhe 2 në zonën e Kelmendit që Fondi i zhvillimit Shqiptar na nënshkruar kontratë me një kompani për ta realizuar këtë proces”, tha kryebashkiaku Marinaj.

Ky proces, jo vetëm do të bëjë pronarë faktikë zotëruarit e pronave, por do të sjellë përfitime të shumta në vënie të efektivitetit të tyre për bizneset të ndryshme, duk e nisur nga agroturizmet.

Në Malësinë e Madhe, pavarësisht ligjit 7501, me mirëkuptim mes banorëve, pronat u ndanë tek “kufijtë e vjetër”, bazuar tek trashëgimia e të parëve. Përmes këtij procesi, synohet që pronat të regjistrohen, hipotekohen dhe të nisë shfrytëzimi i tyre ligjor.

Çmimi i pjeshkëve, dyfish më shtrenjtë se një vit më parë, 180 lekë për kg

Fermerët në zonën e Lushnës shprehen të kënaqur nga prodhimi në plantacionet me pjeshkë dhe kërkesat për shitje.

Mihal Balla prodhimin e plantacionit të pjeshkëve e ka për tregun vendas ku këtë vit çmimi shkon në 180 lekë për kg.

Ai thotë se produkti shitet brenda ditës në tregun e shumicës dhe është shumë i kërkuar nga tregtarët në kryeqytet.

Mihal Balla, fermeri nga fshati Barbullinjë u shpreh për RTSH-në, se “kam 10 dynym tokë të mbjell me këtë kulturë. Pëmët e reja japin mbi 50 kg. Çmimi është me leverdi, ka qenë me 1 mijë lekë (të vjetër)

me 800 por ato të parat kanë qenë dhe 2 mijë lekë. E shesim me pjesë aq sa vjelim.”

Denis Muratin e gjejmë duke vjelë pjeshkë në plantacionin e tij në fshatin Barbullinjë.

Prodhimi i tij, merret nga pikat e grumbullimit dhe shkon për eksport.

Sipas tij, rritja e çmimit ka ardhur për shkak të kushteve atmosferike, të cilat dëmtojnë Ballkanin nga ngrica, por jo Shqipërinë.

Një tjetër fermer po nga fshati Barbullinjë, Denis Murati tha për RTSH se, “Ballkani është goditur nga ngrica ndaj jemi në këto çmime sot në vendin tonë dhe që ka leverdi për

ne. Shtetet ky eksportojmë janë, Kosovë, Maqedonia e Veriut. Vjet ishim tek 65 deri në 70 leke për kilogram ndërsa këtë vit jemi dyfishin e çmimit. Me këtë çmim jemi të kënaqur sepse justifikon dhe shpenzimet tona.”

Fermerët thonë se përpiqen që të ruajnë cilësinë e frutit për të patur një treg të sigurt, por nga ana tjetër ata kërkojnë më shumë mbështetje nga shteti

Barbullinja është zona më e madhe e siperfaqjeve të mbjella me disa varietete të pjeshkëve në Shqipëri.

Klima e ngrohtë ka bërë që pjekja e tyre të bëhet më shpejt

TË NDRYSHME

Studimi - Shqiptarët përdorin dy herë më shumë kripë, mjekët: Mund të zvogëlonim me 30% goditjet në tru

Shqiptarët konsumojnë kripë dy herë më shumë se normat e rekomanduara nga Organizata Botërore e Shëndetësisë.

Përfundimi është rezultat i një studimi të kryer për herë të

pas rekomandimeve të OB-SH-së dhe të gjitha shoqatave ndërkombëtare është sa dyfishi i asaj që rekomandohet. OBSH-ja rekomandon jo më shumë se 5 gramë kripë në 24 orë,” thotë Ledio Çollaku, mjek

ulja e kripës redukton aksidentet vaskulare.

“Sipas studimeve një ulje me vetëm 5 ml të shtyllës së zhivës së hipertensionit do ta ulte riskun për aksidente kardiovaskulare në tru me 30 për qind të rasteve. Nga ana tjetër është parë që këtë do të realizonim vetëm duke ulur kripën në më pak 5 gramë në ditë,” tregon Dr. Çollaku.

Por cilat janë burimet e kripës në ushqimet tona?

“Rreth 67 për qind të kripës që konsumojmë e marrim nga ushqimet e procesuara dhe të gjysmëprocesuara, që e kanë kripën të shtuar në ushqime të caktuara. 15 për qind të kripës e marrim nga vaktet në restorante dhe fastfude. 13 për qind të kripës e marrim nga sasia e shtuar në shtëpi dhe 4-5% e marrim nga përbërja natyrale e ushqimeve,” thotë Dr. Çollaku.

Mjekët apelojnë: Reduktoni ushqimet e përpunuara, si proshutat, sallamet dhe djathërat, dhe çdo ushqim me kripë të shtuar, për të shmanjur sëmundjet.



orëve. Ne konsumojmë rreth 13.8 g kripë 24

parë në një kampion popullare prej 150 personash në dy lagje të Tiranës, të cilëve u është matur natriumi nëpërmjet urinës gjatë 24 orëve.

“Rezultatet ishin të pritshme. Ne konsumojmë 13,8 gramë kripë në 24 orë, që si-

në Klinikën e Sëmundjeve të Brendshme në QSUNT.

Ky rezultat, sipas mjekëve, ndikon në më shumë njerëz hipertensivë e për pasojë edhe më shumë aksidente kardiovaskulare dhe goditje në tru. Mjekët sjellin shembullin sesi

Skema kombëtare e mbështetjes në bujqësi, përfundimi i afatit për aplikim në 30 maj

Afati për aplikimin në Një qarkun e Korçës, është Skemën Kombëtare të vërejtur një interes i shtuar,



gjerë që funksionon me sektorin e blegtorisë dhe bletarisë. Interes të veçantë ka



një interes i shtuar veçanërisht në skemën

Mbështetjes në Bujqësi 2025 po shkon drejt fundit, ndërsa fermerët dhe blegtorët kanë në dispozicion deri më 30 maj, për të përfituar nga pagesat e drejtpërdrejta që ofrohen përmes 8 masave mbështetëse të kësaj skeme.

veçanërisht për skemën e naf-tës, ku janë regjistruar rreth 9300 aplikime deri tani. Po ashtu, fermerët kanë aplikuar edhe për masat e tjera që lidhen me sektorin e blegtorisë dhe bletarisë.

“Interes të veçantë ka pasur

skema e blegtorisë, e gjedhit, ku kemi afërsisht 670 aplikime, ka pasur skema e të imëtave ku kemi pasur 740 aplikime, ka pasur skema e bletarisë ku kemi pasur 630 aplikime dhe ajo që është skema më masive që ka pasur më shumë aplikime është skema e naf-tës ku kemi pasur 9300 aplikime”, u shpreh Vullnet Gjolla, Drejtor i AREB Korçës.

Më tej Gjolla, u bën thirrje fermerëve të përfitojnë edhe nga ditët e mbetura, për të përmbyllur aplikimet e tyre në kohë dhe për të mos humbur mundësitë e financimit.

“Edhe nëse nuk plotësojnë të gjithë dokumentacionin, mjaftojnë të plotësojnë dokumentacionin e nevojshëm për të aplikuar që të përfitojnë nga këto skema. Ne do të vazhdojmë pas datës 30 me kontroll administrativ për plotësim dokumentacioni, por data 30 është data e fundit e aplikimit, të gjithë fermerët që nuk kanë aplikuar, ju bëj thirrje që të vijjnë të bëjnë aplikimet e tyre deri ditën e premte në datë 30 maj”, tha Gjolla.

Skema Kombëtare synon të nxisë zhvillimin e qëndrueshëm të bujqësisë dhe blegtorisë, përmes mbështetjes financiare për fermerët që plotësojnë kriteret. Aplikimet kryhen online në platformën e-Albania, me asistencë nga zyrat e AREB në çdo bashki.

Dita Evropiane e Parqeve, Kumbaro ndan pamje nga zonat e mbrojtura

24 maji shënon Ditën Evropiane të Parqeve

Me rastin e kësaj dite Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Mirela Kumbaro, ndau në rrjetet sociale një video nga parqet tona kombëtare e natyrore, zona të mbrojtura ku natyra ofron të gjitha përmasat më magjike të saj.

24 maji është një ditë që kremton Zonat e Mbrojtura në të gjithë Evropën, që u lançua në vitin 1999 nga Federata Europare për të vënë theksin tek Zonat e Mbrojtura Evropiane.


Dita Evropiane e Parqeve i ka fillesat e saj nga krijimin e parqeve të para kombëtare në Evropë, që fillimisht ishin nëntë të tillë, të krijuar në Suedi në 1909.

Zonat e mbrojtura në vendin tonë datojnë në vitin 1940 me shpalljen dhe krijimin e rezervatit të parë shtetëror të gjuetisë (Kune-Vain-Tale) në

Lezhë dhe në Parkun Kombëtar të Malit të Tomorit në Berat.

Krijimi i një parku kombëtar

bëtar i Dajtit: Parku Natyror i Dajtit, Parku Kombëtar “Lugina e Valbonës”, Parku Kom-



është një mënyrë për të ruajtur trashëgiminë tonë të përbashkët natyrore dhe kulturore.

Disa nga parqet kombëtare të Shqipërisë janë: Parku Kom-

bëtar “Thethi”, Parku Kombëtar i Lurës, Parku Kombëtar “Mali i Tomorit”, Parku Kombëtar “Divjakë-Karavasta”, Parku Kombëtar “Llogora”.

UNESCO: Lugina e Vjosës të shpallet Rezervat i Biosferës

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit njoftoi se UNESCO

dimisht përfshirjen e Vjosës në listën e pasurive botërore, si



vojë më tej ruajtjen e natyrës dhe zhvillimin e qëndrueshëm në rajon.

Lumi Vjosa është i njohur si “lumi i fundit i egër në Europë”, pasi rrjedh në mënyrë të lirë për rreth 270 km, nga burimet në malet e Pindit në Greqi (ku quhet Aoos), deri në derdhjen në detin Adriatik në Shqipëri.


Lugina e Vjosës është një ekosistem unik, që përfshin habitate të ndryshme si pyje, ishuj ranorë dhe toka bujqësore, më shumë se 1100 lloje bimore dhe shtazore, përfshirë specie të rrezikuara si

ka dhënë rekomandimin zyrtar për shpalljen e Luginës së Vjosës si Rezervat i Biosferës.

“Është më shumë se një vlerësim ndërkombëtar, është një njohje për bukurinë e egër të Vjosës, mirënjohje për njerëzit e atyre trevave që jetojnë në harmoni me natyrën dhe për përpjekjet e përbashkëta në mbrojtjen e lumit të fundit të egër të Europës”, u shpreh ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Mirela Kumbaro.

Ministria theksoi se ky rezultat nuk është i rastësishëm, por vjen pas një pune intensive të institucioneve përkatëse. Ajo përmendi vizitën e parë të drejtoreshës së përgjithshme të UNESCO-s, Audrey Azoulay, në Luginën e Vjosës në shkurt 2023, si dhe përkushtimin e vazhdueshëm të specialistëve të Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura.

“Vjosa sot nuk është vetëm një lumë, por është një model i zhvillimit të qëndrueshëm, ku natyra frymëzon. Në shtator të këtij viti, pritet që Këshilli i Rezervateve të Biosferës i UNESCO-s të miratojë përfun-



një himn për natyrën dhe për njerëzit”, deklaroi Kumbaro.

Shpallja e Luginës së Vjosës si Rezervat i Biosferës do të përforcojë statusin e saj ndërkombëtar dhe do të promo-

vidra, pelikanët dalmatianë dhe peshq endemikë, është një korridor migrimi për shumë shpendë dhe një zonë e rëndësishme për biodiversitetin europian.

KËNDI I EKSPERTIT

Pamja e qiellit gjatë muajit qershor 2025
Më 11 qershor - Hëna e plotë.
Hëna do të jetë e vendosur në anën e kundërt të Tokës me

Kalendari bujqësor, muaji qershor 2025

Përgatitur nga Prof. As. Dr. Eqrem Meçollari

në 16 orë (Tabelat më sipër).

Lagështia e Ajrit
Lagështia më e përshtatshme kur njerëzit ndihen më mirë

Parashikimi i motit për muajin qershor 2025 në Tiranë (Zona bregdetare)

Dt.	Temperatura e ajrit °C		Temp. reale që ndjehet °C	Shiu		Era				UV Indeks	Përshkrimi i shkurtër i motit	Simboli
	U	L		mm	Orë	Km/Orë		Drejtimi				
						D	N	D	N			
1	19	29	19-31-29	0	0	6	7	VL	VVL	3	Vranësirë dhe lagështi	
2	19	28	19-33-28	0	0	6	4	JJL	V	10	Diell i bollshëm	
3	18	27	18-32-27	0	0	4	6	VL	VVP	10	Diell	
4	16	27	17-28-25	1.4	1	9	7	VP	V	7	Pjesërisht me diell me ndonjë stuhi pasdite	
5	16	25	16-29-24	0	0	7	11	VVL	VVP	10	Kryesisht me diell	
6	17	26	17-30-24	0	0	7	7	VL	V	10	Plot me diell	
7	16	26	17-30-25	0	0	6	4	JL	J	10	Kryesisht me diell	
8	17	26	18-26-26	0	0	7	2	LJL	LJL	3	Vranësirë	
9	19	27	19-32-27	0	0	4	4	JL	JJL	10	Kryesisht me diell	
10	20	29	20-29-28	0	0	9	9	JL	J	3	Vranësirë	
11	20	30	20-34-29	0	0	6	4	JJP	VVP	11	Pas largimit të reve, rikthehet dielli	
12	19	28	19-33-27	0	0	6	6	VVL	VP	11	Kohë me diell	
13	20	29	21-34-29	0	0	4	7	PVP	VVP	11	Plot me diell	
14	21	29	22-34-29	0	0	7	7	VVL	V	11	Lagështi me plot diell	
15	21	30	22-36-31	0	0	6	6	VVL	V	11	Lagështi me plot diell	
16	21	31	23-36-32	0	0	4	6	LVL	VP	11	Diell dhe lagështi	
17	21	30	23-36-32	0	0	4	6	LVL	V	11	Diell	
18	21	31	21-34-30	0	0	11	9	VL	VVL	11	Kryesisht me diell	
19	21	30	20-33-28	0	0	11	9	VVI	V	11	Plot me diell	
20	21	29	21-33-28	0	0	7	6	VL	VVL	11	Plot me diell	
21	21	31	21-35-30	0	0	6	6	JJL	PVP	11	Diell	
22	22	31	20-36-30	0	0	4	11	VVP	PJP	11	Plot me diell	
23	20	30	19-32-29	0	0	13	15	V	VL	11	Plot me diell	
24	19	33	19-36-31	0	0	9	9	V	VVL	11	Plot me diell	
25	19	32	19-34-31	0	0	9	7	VP	PJP	11	Plot me diell	
26	22	32	21-33-30	0	0	11	7	PJP	PVP	11	Diell ë shndritshëm	
27	21	31	19-33-30	4.2	4.5	11	11	VP	V	8	Interval i reve dhe diell me ndonjë stuhi në zonë	
28	20	29	17-33-29	7.2	4.5	9	11	V	VVL	11	Interval i reve dhe diell me disa stuhi	
29	20	29	19-33-29	3.9	2	9	9	V	VVL	10	Kohë me re dhe diell me disa stuhi	
30	20	30	20-33-29	2.8	2.5	9	7	VVP	V	11	Pjesërisht me diell me disa stuhi	

Treguesit mesatarë klimatikë gjatë muajit qershor 2025

Treguesit	Tiranë	Korçë	Vlorë	Shkodër	Dibër	Gjirokastrë
Temperatura e ajrit						
Mesatare (°C)	25	21	25	26	18	21
Maksimale (°C)	28	24	27	29	23	25
Minimale (°C)	23	18	24	23	13	17
Më e larta gjatë viteve (°C)	38 (2021)	34 (2009)	34 (2021)	37 (2012)	32 (2013)	37 (2021)
Më e ulta gjatë viteve (°C)	14 (2009)	9 (2021)	15 (2013)	14 (2009)	1 (2021)	7 (20210
Numuri i ditëve me Temperatnë + 30°C (Ditë dhe %)	8 (27)	4 (13)	5 (17)	13 (43)	2 (7)	4 (13)
Numuri i ditëve me Temperat në + 18°C (Ditë dhe %)	30 (100)	28 (93)	30 (100)	30 (100)	26 (87)	28 (93)
Numuri i ditëve me Temperat në -0°C (Ditë dhe %)	0	0	0	0	0	0
Temperatura e ujit në det °C						
Temperatura mesatare			22.6			
Temperatura minimale			20.2			
Temperatura maksimale			25			
Era						
Shpejtësia e erës (Km/Orë)	14	11	19	12	10	12
Temperatura e erës (°C)	23	18	24	23	12	17
Reshjet (Shiu)						
Shi (mm)	105	122	54	72	182	127
Numuri i ditëve me shi (Ditë dhe %)	6 (19)	8 (28)	3 (9)	3 (10)	11 (37)	8 (26)
Sasia rekord e shiut gjatë një dite (mm dhe vit)	63.8 (2016)	57.1 (2009)	62.4 (2009)	72.9 (2014)	40.5 (2010)	39.2 (2021)
Dëborë (cm)	0	0	0	0	0	0
Lagështia e ajrit (%)	84	71	65	61	74	64
Shikueshmëria (Km)	9.67	9.06	9.84	9.7	8.99	9.56
Mbulimi i qiellit me re (%)	17	25	13	18	26	18
UV index	7	6	7	7	5	6
Orë me diell nëDitë	15	15	15	15	14	15
Gjatësia e ditës (Orë)	15:09	15:05	15:03	15:15	15:12	15:00
Vlerësimi i muajit	Mirë	Mirë	Shumë e	Shumë e	Mirë	Mirë

shiut, stuhive dhe mjegullës. Ng-jarjet e motit që mund të ndodhin gjatë udhëtimit për në Tiranë: 6 herë shi, 6 herë stuhi, më pak se 1 herë mjegull, por mund të jeni të qetë për rresbeshe. Vitet e fundit, mesatarisht, vetëm 6 ditë kanë qënëme shi. Tirana në qershor do të përjetojë ditë të nxehta me qiell shumë të vranët. Zakonisht temperatura do tëluhatet rreth 29°C dhe do të ndihet për 34°C dhe era do të jetë flad i lehtë.

Temperaturat e larta ditore do të rriten me 4°C, nga 26°C në 30°C, rrallë do të bien nën 21°C ose të kalojnë 34°C. Temperaturat e ulëta ditore do të rriten me 3°C, nga 13°C në16°C, rrallë do të bien nën 10°C ose do të kalojnë 19°C.

Për referencë, më 3 gusht, dita më e nxehtë e vitit, temperaturat në Tiranë zakonisht variojnë nga 18° C në 32° C, ndërsa më 4 janar, dita më e ftohtë e vitit, ato shkojnë nga 0° C në 11° C.

Zhvillimi i reve

Muaji qershor në Tiranë do të përjetojë një rënie shumë të shpe-

jtë të mbulesës së qiellit me re, ku përqindja e kohës që qielli është me vranësira ose kryesisht vranë-sira do të ulet nga 34% në 14%.

Dita më e kthjellët e muajit do të jetë 30 qershori, me kushte të kthjellëta, kryesisht të kthjellëta ose pjesërisht me vranësira në 86% të kohës. Gjatë muajit qershor mbulimi mesatar i qiellit me re do të jetë 27%.

Për referencë, më 7 dhjetor, dita më e vrenjtur e vitit, shansi i kushteve të mbuluara me re ose më së shumti me re është 55%, ndërsa më 21 korrik, dita më e qartë e vitit, mundësia e qiellit të pastër, është 91%.

Zgjatja e Ditës

Në qershor, gjatësia e ditës gradualisht fillon të rritet me rreth 12 minuta. Dita më e shkurtër do të jetë 1 qershori dhe ofron 14 orë e 56 minuta dritë dite, lindja e diellit do të jetë në orën 5:11 e mëngjesit dhe perëndimi i diellit do të jetë në orën 20:07 dhe dita më e gjatë do të jetë 22 qershori me 15 orë 10 minuta ditë, lindja e diellit do të

Parashikimi i motit për muajin qershor 2025 në Korçë (Zona e Ftohtë)

Dt.	Temperatura e ajrit °C		Temp. reale që ndjehet °C	Shiu		Era				UV Indeks	Përshkrimi i shkurtër i motit	Simboli
	U	L		mm	Orë	Km/Orë		Drejtimi				
						D	N	D	N			
1	12	27	13-30-25	0	0	2	2	JP	PVP	10	Kohë me re dhe diell	
2	12	25	13-30-24	0	0	4	6	JP	V	10	Vranësira shpërndahet për pak diell	
3	11	24	12/29/2023	0	0	4	6	PJP	P	11	Plot me diell	
4	8	25	10/29/2024	0	0	7	7	P	VP	11	Kryesisht me diell	
5	8	21	10/26/2020	0	0	7	4	VVL	VVL	11	Diell i bollshëm	
6	9	21	10/26/2020	0	0	4	2	VL	VVP	11	Plot me diell	
7	8	22	10/26/2021	0	0	4	4	JJL	PVP	11	Kohë me diell dhe pak re	
8	9	22	11/24/2022	0	0	4	6	PJP	P	4	Kryesisht vranësirë	
9	11	25	13-29-23	0	0	4	4	JJP	PJP	11	Kryesisht me diell	
10	13	26	14-26-25	0	0	6	6	JJL	J	3	Vranësirë	
11	13	26	14-31-25	0	0	7	6	JJP	PVP	11	Pas largimit të reve, rikthehet dielli	
12	11	26	13-31-25	0	0	2	4	LJL	P	11	Diell	
13	13	26	14-30-25	0	0	2	4	VVP	VVL	11	Kryesisht me diell	
14	13	26	14-31-25	0	0	4	4	LVL	V	11	Diell	
15	13	26	15-31-25	0	0	4	4	VVL	V	11	Plot me diell	
16	13	27	16-31-26	0	0	4	4	VP	VVP	11	Kohë me diell	
17	13	27	14-32-26	0	0	2	6	VL	V	11	Diell i bollshëm	
18	13	27	14-31-26	0	0	7	6	VL	VL	11	Diell deri pjesërisht me re	
19	13	25	14-30-24	0	0	6	6	VL	VL	11	Plot me diell	
20	13	25	14-29-24	0	0	4	2	VVL	V	11	Plot me diell	
21	13	26	14-31-26	0	0	2	6	JJP	PVP	11	Kohë me diell	
22	13	27	13-32-27	0	0	4	4	VL	V	11	Kohë me diell	
23	12	26	11/29/2025	0	0	11	9	VVL	VL	11	Plot me diell	
24	12	29	12-33-28	0	0	4	4	V	VL	11	Plot me diell	
25	11	29	12-33-28	0	0	6	4	JP	PJP	11	Diell	
26	14	29	16-31-27	0	0	9	4	JP	PJP	11	Diell	
27	13	28	14-32-27	0	0	6	4	P	V	11	Pjesërisht me diell	
